BIBLIOTEKA
SHTETIT
8IH-7
HIP.

Shkëlqim
Hajno

VJEDHËSI I VITEVE



Skica
e tregime
satiro
humoristike

8Sh-7
Hip.

Shkëlqim
Hajno

VJEDHËSI I VITEVE

skica
e tregime
satiro –
humoristike

20234
29963

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

UNË DHE MISRI ME KUBIKË

Meqë e solli rasti, e ndjeva për detyrë që pas autokritikës që bëra në kolektiv t'ia tregoj edhe lexuesit se si e pësova... Ndoshta tani është vonë dhe misri me kubikë ka kohë që mbillet po, duke parë se në mos kjo ndonjë tjetër mund t'u bëhen barrë shokëve të bujqësisë, vendosa ta them, me qëllim që të lëkundurit si kallinj thekre në bujqësi të heqin dorë nga mania për të qenë «docentë» e të kenë më shumë besim edhe te të përparuarit dhe te metodat e reja. Nejse, që të mos e zgjat, ju patjetër e keni dëgjuar atë metodën e famshme të Elbasanit për mbjelljen e misrit me kubikë. Që të gjithë ata që merren me bujqësi e dinë këtë marifet, po mendja më thotë se edhe të tjerët duhet ta dinë, pasi e mira është që njeriu të mos kujtohet për bukën vetëm kur ia bën me sy në tavolinë. Nejse, njeriu s'e paska të lehtë të fliska keq për vete.

Unë vetë nuk shkela dot në Elbasan për eksperiencë me ata shokët e rrethit, sepse ashtu e solli puna. Ato ditë e gdhija në malin e Bunaçes për ca probleme të blegtorisë, por ama Zamirën, kryeagronomen, shefin e sektorit të Skaranit, Brahon dhe Malen, brigadieren, i dërgova sakaq.

Tri ditë e tri net ndenjën në Elbasan e, me t'u kthyer Zamira, ia nisi ligjëratës pa më lënë radhë ta pyesja:

— Ajo është punë, o kryetar. Hajde, misër, hajde! tetëdhjetë kuintalë për hektar... — dhe, si hapi një bllok xhepi, vazhdoi:

— Kubikët, që thua ti, ndërtohen me pleh me dimensione 10 x 10. Në të mbillen tri kokrra farë dhe, kur filizat të kenë nxjerrë tri fletë, hiqen dy më të dobëtit.... Hajde, misër, hajde!...

Zamira më fliste me aq pathos, si ta kishte zbuluar kulturën e misrit. «Për këtë baltë, thashë me vete, kësaj nadi qenka bërë mendja kubikë. Mbjellim ca kokrra, heqim ca fletë e, ku ta di unë se çfarë!» Megjithatë e dëgjova me seriozitet dhe mendja më shkoi te telashet që do të na hapte kjo punë. «Hajde, të kam rixha, të grumbullosh mijëra tonë pleh, të mobilizosh kaq forca pune, po dëri këto, po ka burrë nëne të prodhojë miliona kubikë? E huaaa!»

Kur Zamira mbaroi së shpjeguari teknologjinë e këtij marifeti, unë, për të dalë nga kjo gjendje, vendosa ta kundërshtoja, por me të urtë:

— Dakord, o babam. Mirë është dhe kështu, po a e di ti sa metra mbi nevelin e detit është ai i uruar Elbasani? Po pse, njëlloj i pakemi kushtet me ata, o shoqja kryeagronome? Kështu de! Të ishim ne në Elbasan jo tetëdhjetë kuintalë misër po njëqind kuintalë do të mermim për hektar.

Mirëpo Zamira që e mençme e s'tërhiqej lehtë.

— Kryetar, e ke gabim, kryetar! Por ata, këtë metodë e kanë zbatuar në kooperativa maldre si kjo jona edhe kanë marrë atë rendiment që thashë.

Pa filloi më pas të sjellë argumente, të cilat me

siguri i kishte mbajtur shënim gjatë ditëve që qe në Elbasan.

— Ama, muhabet na bën edhe ti, demek, — i thashë, kur u ndamë, për t'i lënë të kuptonte se unë s'qeshë dakord. — Ti flet, sikur ne të mbillnim vetëm misër në kooperativë, ore babam.

Po, megjithatë ajo puna e kubikëve filloi të më rrahë në kokë si çekani i xha Labos. E, fundja pse t'jua fsheh, more shokë, gjithë sëkëlldinë e kisha të mos turpërohesha para popullit. Pa, po ta dija se më dilte mbarë puna e kubikëve, pse do ta kundërshtoja. Le që atë vit ishte punë që s'bëhej. M'u mbush mendja, si një e një bëjnë dy, se me e pamundur të realizohej. Hiç, po vetëm një hektar toke kullufiste mbi 100.000 kubikë. Marshallah!... Pa le plehu... ku ta gjenim, vetëm po të binte nga qielli! «Elbasani», thotë Zamira. Po ai ka atë ligen me trofë që nuk i gjendet fund.

Me këto mendime në kokë hyra në mensë. Për dreq, edhe copat e bukës që thveja në piatë, me të cilat do të bëja përsheshin, që e haja me aq shije, më dukeshin katrore të mëdha, si kubikët e misrit. «A thua kanë të drejtë?»

Pagova dhe dola jashtë. Para zyrave qenë mbledhur një grup kooperativistësh që po dëgjonin me vëmendje ligjëratën e Brahos, i cili mbante edhe ai në dorë një bllok shënimesh. «Kubikët», thashë gati me zë. Më qe mbushur mendja top, se puna e këtyre kubikëve qe pesë me hiç.

Atë ditë prisnim të na vinte plani i aprovuar nga rrethi. Ja kisha frikën. Dhe ja, nuk vonoi, plani erdhi me një ndryshim. Nga 100 hektarë misër, 40 do të mbilleshin me kubikë. «Bo, bo! Sikur e prisja. — Kalova kurrizin e dorës mbi sy se, helbete, mos

trurí po sajonte të paqena, po shifrat nuk u tundën fare. — Sos janë pak, de, dyzet hektarë! Po sikur të mos i arrijmë? Hajde, çipë e turpit, hajde!»

Pas disa ditësh plani do të shtrohej në mbledhjen e zgjeruar të kryesisë. Nga diskutimet në brigadë, shifra 40 ishte aprovuar, po kishte brigada që kishin propozuar për t'u rritur, si ajo e Malës. «Jepi, shoqja Male, jepi», — thosha me vete jo pa inat.

Mbledhjen e kryesisë e hapa unë, Rato Destani, së më takonte. Si u kalova një sy tejembanë fshatarëve, hodha mendimin:

— Unë mendoj që shokët ta shkoqitin mirë punën para se të diskutojnë. Përgjegjësi, përgjegjësi dhe jo aguridhe! — Po, si për inat, pa kërkuar leje e më the të thashë, fjalën e mori shoqja Male.

— Nuk kemi çfarë të mendojmë (Mua m'u duk se më hodhën një gjym me ujë kroi në çaçkë të kokës). Brigadave hesapet u dolën mirë. Jemi dakord që sipërfaqja e kubikëve jo vetëm të mos ulet por, po u pa e arsyeshme, në ndonjë brigadë si imja mund edhe të ngrihet. Këtë ta diskutojmë së bashku. — M'u duk se që çasti kur duhej të ndërhyja:

— Bukur, shoqja Male. Diskutim shumë optimist... po doja të dija, si fshatar i thjeshtë, ç'mendon brigada për plehun, a mund të sigurojmë për tërë sipërfaqen; po për... po për... — dhe nuk më kujtohet sa «po për» i dreitova. «U gozhdua», — thashë me vete, por jo:

— Shoku kryetar, për punën e plehut kemi menduar dhe do ta sigurojmë. Do ta grumbullojmë me

kafshë, me makinë, edhe me krahë. Hesapet janë bërë dhe burimet janë gjetur. Kubikët do t'i rregullojmë... kryetar. Vetëm nga ju kërkojmë të na sillni makinat për prerjen e tyre...

Atý s'u përmbajta:

— Po ç'jam unë, atëherë? Bazë furnizimi? Makinat nuk varen nga unë. Këtë punë e ka rrethi. Pikë!

— Rrethi nuk i ka vetëm për inventar, shoku kryetar, po duhet lëvizur ca.

«Të ka faj Malja? Jepi, Male, — thashë me vete. — Po kush është kryetar, xhanëm?!»

U ngrit dhe brigadieri i brigadës së parë, Çunoja me mustaqe:

— Edhe brigada ime është dakord që dyzet hektarët të mbillen me kubikë. Veçse ajo baza e furnizimit të bëhet e gjallë e të mos vonojnë makinat e kubikëve.

O, të keqen e mustaqeve me bisht, o Çuno! Mirë që nuk të vajti mendja të thuash 80 hektarë, o të keqen, këto mendoja kur i thashë që nga presidiumi:

— E di ti, shoku Çuno, se në prill dyzet hektarët e misrit duan ujë dhe ky ujë do të dalë nga rezervuari? Se me llafe ato nuk vaditen, apo jo?

— Besoj, si kryetari, edhe në të tjerët e dimë këtë punë?! — iu drejtua fshatarëve me romuz.

— Nuk ta pata aty llafin, more Çuno, jo, por i duhet vënë rreth kokës se, po e boshatisëm rezervuarin që në prill, si do të vaditim më tutje.

— Dëgjo, kryetar! Unë di vetëm një gjë: në vjet, duke thënë «jo nuk kemi ujë», «jo nuk kemi tokë», e «jo klima kështu», e «jo rrezet e diellit bien ashtu», e shumë sebepe të tjera, nuk ua pamë hairin as fasuleve e as patateve. Po sivjet, ama, që bëmë më shumë punë se fjalë, edhe fasulen e tejkaluam, edhe patatja u

bë det. Pse, mund të thuash ti, kryetar?... Ne patëm sukses, o kryetar edhe në fasule, edhe në patate, se të gjithë i lanë shëndetin dembelisë. Vetë ti, o kryetar, nuk u ndave, po flije arave me ne. — Kryetari heshtte. «Ky Çunoja ta mbush mendjen, s'ke ç'i thua». — Ndërsa këtë misrin me kubikë nuk e di pse e ke marrë zët, dhe po mundohesh të na e mbushësh mendjen dhe neve, — vazhdoi Çunoja. — Ti mendon mos të të zërë turpi, kryetar vëllai. Po ne s'kemi cipë në faqeza? Nuk paskemi namuz, thua?

Demek, s'ta mbushim syrin fare, ë?

Zhurmë. Çunoja u ul.

Hajde, të rrahur që më bënë tëmthat, hajde. Nuk e di pse, po m'u duk sikur Çunoja me mustaqe nuk foli me fjalë, po më goditi në çaçkë me kubikë. Koka m'u bë si me xhunga-xhunga.

I fundit u ngrit korrier Aliu:

— More, po jeni në vete ju, apo jo? Puna është që të marrim rendimente sa më të larta, o baballëk. Atëherë do t'i kemi plot hambarët e me ta edhe kokat e atyre që lëkunden...

Demek, edhe kokën time, mendova jo pa dhembje! Së fundi u pleqësua njëzëri për 40 hektarë. Kuptohet more shokë, edhe autokritikë bëra, po, pse t'ju fsheh, kisha prapë ca frikë...

Pas mbledhjes, kooperativa gumëzhiu nga puna. Duheshin 1.400.000 kubikë. Mos qeshni, o shokë, po kjo shifër kishte filluar të më dilte në gjumë: 1.400.000! Po vetëm t'i numërosh dhe nuk ia del dot. Jo, po të këtë njeri të numërojë deri në 1.400.000, le të urdhërojë e të vijë këtu në kooperativën e Çoçkos, se kam për t'ia lënë vendin... Më dilte ajo e uruar shifër në ëndërr. Bile një natë, si u shtrimë të flinim, gruaja më pyeti:



— Rato, nuk je mirë sot më duket!

— Jo, jo njëmilion e katërqind mijë! — iu përgjigja.

Kështu më ndodhi more shokë, kështu, po brigadat filluan të më qetësojnë. Ditë për ditë më raportonin:

— Shoku kryetar, njëzet mijë kubikë!

— Shoku kryetar, dyzet mijë kubikë!

— Shoku kryetar, vajtëm njëqind mijë.

Këmbët s'më zinin dhe, sa te njëra brigadë te tjetra. Mirëpo një ditë Zamira më ngau. Në zërin e saj të bukur, që përtej, mund të dalloje romuzin dashamirës:

— U lodhëm, u lodhëm, por ama vajtëm njëqind mijë kubikë! Në qendër më njoftuan se sivjet dhjetë hektarë do të mbillen me duhan, — foli ajo.

Po i hetoja fytyrën. More, kjo sorkadhe vazhdon të më ngacmojë kështu?

Por ajo e kishte seriozisht:

— Jemi planifikuar të mbjellim duhan. Ti vetë ke thënë se bujqësia po ecën përpara, apo jo?

— Dëgjo, Zamira, edhe duhan do të mbjellim, e pse jo.

Po ecnim anës parcelave, kur sytë na kullotën tej, te ca togje të mëdha, që nxinin. Zamira, që e kuptoi memecllëkun tim, ia nisi:

— Janë kubikët, kryetar. Pa i mbuluam me kartë, pa i mbuluam me baltë e me plastmas.

Unë e shikoja dhe më vinte plasja me veten: Hajde, Rato Destani, që kudërshtove për kubikët, hajde! E po rëndësi ka të kuptosh, i dhashë kurajë vetes dhe, si ai nxënësi që gabon, nuk bëra zë, po ndoqa pas Zamirën, që më kishte lënë një litar kali pas.

PARA DHE PAS VITIT TË RI

Tafili me Zelkon janë burrë e grua. Do të thoni ju, ky prezantim nuk tregon asgjë. Sidoqoftë, ne e themi që në fillim se qëllimi ynë nuk është t'i bëjmë të tjerët të qeshin. Historinë e Tafilit me Zelkon, që kanë katër fëmijë e që vetë punojnë në njërën nga kooperativat e Kurveleshit, do ta tregojmë për tjetër qëllim.

Ngjarja përsëritet në prag të Vitit të Ri. E. Viti i Ri, veç gëzimeve, transformimeve të fshatit, rritjes së vlerës së ditës së punës, shkollës së re të mesme bujqësore, mishit të pjekur e rakisë, kooperativës së-në i solli edhe ca telashe.

Zelkoja me Tafilin e fëmijët Vitin e Ri e festojnë në një mënyrë krejt origjinale. Çdo vit (që më pesëmbëdhjetë dhjetor), si mbushin trastat me arra e gështenja, fusin në dy thasë të bardhë dy kecër të therur, ngjeshin në portofol lekë, nisen për të festuar Vitin e Ri në qytet...

Stacionin e parë e kanë në Vlorë. Aty motra e

Zelkos është vendosur që para dhjetë vjetësh. Pas pesë ditësh në Fier. Këtu, miqësia dhe zakoni e do që Tafili me Zelkon të rrinë më shumë, pasi veç qytetit, në Frakull dhe Levan Tafili nuk ka si mos t'u kthejë vizitën e beharit nja dy-tre shokëve, me të cilët ka bërë ushtrinë në Leskovik, më 1950!

Si kalojnë të dhjetë ditët e planifikuar në Fier, Tafili me Zelkon ndryshojnë kursin e udhëtimit dhe, pasi presin biletat tek ajo shoqja me nishan në faqe, hipin në trenin e mëngjesit, dhe kështu 31 dhjetori i zë brenda në Tiranë, në apartamentin e bukur të vëllait të Tafilit, Jetnorit.

Është e kuptueshme, se nata e Vitit të Ri gdhihet. Pa feksur drita, aty nga ora 4 e mëngjesit, sa mbaron programi i televizionit, vëllai i Tafilit hap magnetofonin me këngë labe e të ndryshme dhe në moment Tafili nxjerr shishen e rakisë, që e ka prurë me vete, e shkund nja dy herë për t'u treguar të tjerëve zinxhirët në grykë dhe, pasi kënaqet me ballëkazanin e vet, nis ligjëratën:

— Po, të më pyesin mua, kot i vënë këto këngët me dhjolina, e më the të thashë. Mbushe, or lumë-madh, me ata të estradave që të shkyejnë së qeshuri...

Të nesërmen bëhet vizita në pallat. Tafili me Zelkon i njohin të gjithë të pallatit, pasi vizitat e Vitit të Ri i përsërisin çdo vit. Ata dinë me interesi sa veta banojnë në atë hyrje, sa të martuar e sa beqarë, sa nxënës e sa pensionistë dhe a shkojnë të gjithë në mbledhjen e lagjes...

Nga data dy deri më nëntë janar fillojnë e mbarojnë vizitat te të gjithë të afërmit dhe fshatarët e ardhur prej kohësh në Tiranë. Pas njëzet e pesë ditëve, aty nga data dhjetë janar, Tafili me Zelkon

kthehen të përmalluar në fshat dhe që të nesërmen fillojnë nga puna.

Jemi të bindur se dikush mund t'i harkojë vetullat dhe bëhet gati të pyesë: — Si ka mundësi t'i lërëllamtumiqën punës tjetri, njëzet e pesë ditë, si pa gjë të keq? Po kryesia e kooperativës ç'bën, apo e ka dërguar vetë Tafilin me Zelkon në qytet për eksperiencë? Po fshati pse bën sehir?

Po mos u ngutni, or vëllezër, se që të gjithë kanë luftuar, bile në front unik e, për t'u bindur për këtë, shikoni ç'i punuan sivjet çiftit origjinal të fshatit tonë:

* * *

Tafili me Zelkon ndërruan taktikë. Me pretekst se gjoja kishin një njeriun e tyre të sëmurë, Tafili me Zelkon edhe këtë vit u nisën për të festuar Vitin e Ri qysh më pesëmbëdhjetë dhjetor dhe po atë ditë u gjendën në Vlorë për të bërë «nxemjen» para festës tradicionale. Në Vlorë, te motra e Zelkos, që ditën e parë Tafili ndjeu një ulje të ndjeshme të temperaturës familjare.

— Tafil, — hapi muhabetin e kunata, Beronja, — statut më vete paski ju të bujqësisë?! Ne e kemi ndryshe punën: për çdo hall që na del, pesë ditë leje pa të drejtë rroge na japin.

Po Tafili, që pi duhan të fortë, i priti me qetësi këto fjalë të së kunatës:

— Epo mendon kryesia, Beronjë motra, se ti e di që ne nuk bëjmë leje të zakonshme, — tha ai, duke menduar se i dha përgjigjen e merituar.

— Po sikur kryesitë e kooperativave t'i jepnin çdo anëtari nga 20 ditë leje, ç'mbetej pastaj për në kooperativë?

Tafili ndjeu t'i thahej pështyma në letër të cigares, e në zemër ndjeu majën e mprehtë të padurimit.

— Të forta i paske shutat sivjet, o kunatë, por, po qe se të bezdisim, ne edhe ngrihemi e shkojmë. Nuk duam t'ju prishim rehatin!

Më vonë erdhi edhe i shoqi i Beronjës e, megjithëse muhabeti u ngroh e Zelkoja pothuajse e harroi bisedën e së motrës, Tafili atë natë foli shumë rrallë e në fytyrë sikur i kishte rënë boja e dyllit. Pas dy ditëve (nga pesë që qe planifikimi), Tafili me Zelkon e lanë Vlorën të zemëruar.

Por edhe në Fier, Tafili qysh ditën e parë diçka ndjeu. Shkuan edhe në Levan e Frakull, po njerëzit nuk ishin të ngeshëm për muhabete të gjata. Të gjithë shkonin në punë që herët në mëngjes e kthehesh in me merakun e punës.

Natën e dytë Tafilit nuk iu durua e ia shprehu pakënaqësinë shokut të tij traktorist me të cilin, siç thamë që në fillim, më 1950 kanë qenë bashkë ushtarë. Po Hazbiu, duke fërkuar mustaqet me kurrizin e dorës, i tha pa të keq:

— Tafil, e ke dëgjuar atë këngën që thotë «krahët e fortë t'i vëmë Shqipërisë»? Ne, ditën e diel e bëjmë të diel e jo një muaj me të diela, Vitin e Ri e bëjmë ditën e Vitit të Ri, se ndryshe do bëhej katrahurë.

— Dreq, o Hazbi! Ti qenke bërë i librave, pa le!

— Dhe, si i dha njëherë xhaketës pas, vazhdoi:

— Po çfarë më quan ti mua, dembel, a? Jo, or, jo! Kam bërë 350 ditë pune unë, më dëgjon? 350 kokrra

ditë e jo me traktor, po me krahë, më dëgjon? Nga dy norma kam përlarë. Edhe Zelkoja ka shënuar 300 ditë të thata, more vesh, e tani do bëjmë qejf, derisa të fillojë viti tjetër.

— Të tjerët kanë futur nga 400 ditë dhe nuk bëjnë qejf duke ikur nga fshati njëzet ditë, o Tafil!

Tafil Begës iu valëzua balli nga rrudhat dhe thellë në shpirt ndjeu t'i thyhej diçka si qelqi. Të nesërmen, kur po ktheheshin përsëri për në Fier, Zelkoja i thoshte të shoqit:

— Tafil, u bëmë gazi i botës, nuk e sheh? Bota punojnë. S'e kanë mendjen te Viti i Ri.

— Pse, zotrote tani e more vesh që punojnë bota?! Apo flet kështu se u puthe në buzë me motrën tënde, — dhe, sikur t'ia kishte blerë mendjen Zelkos, i tha:

— Ti, po deshe, kthehu në fshat, më dëgjon? Unë Vitin e Ri do e bëj mu në Tiranë, te vëllai!

Udhëtimi vazhdoi. Më 31 dhjetor Tafili me Zelkon e me fëmijët arritën në kryeqytet. Vëllai i Tafilit, Jetnori, që është oficer, erdhi me vonesë. Domosdo që u gëzua për vëllanë e kunatën. U shtrua tavolina e filloi ahengu. Uleshin e ngriheshin gotat me raki, siç shtroheshin e avullonin mezet. Deri pas mesnate muhabeti vajti zile.

— Po pikërisht kur në televizor dolën ata të estradave, që Tafili i ka aq qejf, në tavolinë biseda u përzie. Aktori luajti një skeç për fshatin, taman për ata që lënë punën për hiçgjë e shkojnë në qytet.

— Bukur, ë, Tafil, — iu drejtua vëllai, — besoj se këtë material Shkodrës ia kanë dënguar ata të kooperativës suaj?

— Kur të kthehem do pyes, — tha Tafili, që shpejt e ndjeu kunjin.

— O huaaa, sa të kthehesh ti, për dhjetë ditë, kuvesia nezik t'i shkruajë përsëri estradës, — thumboi Jetnori.

— Le t'i shkruajë, po t'i thotë, ama, që kam bërë edhe 350 ditë pune.

Gotat mbi tavolinë nuk po i prekte njeri. Edhe fëmijët, si ta kishin bërë me fjalë, nuk loznin më. Jetnori mori gotën:

— Hajde gëzuar, për shumë vjet, Zelko, e me katërqind ditë vitin tjetër!

— Të lumtë goja! — ia ktheu Zelkoja që shikoi nga Tafili sikur të kërkonte t'i thoshte: «Tafilziu, tundu, se mirë e ka Jetua. Të ikim që nesër».

Po Tafili nuk e ulte antenën. Qe futur në të thella. «Fol, o gur, fol, o mur!» Qetësinë e prishi Jetnori.

— Nesër nuk do të tundeni këtej. Të tërë e kanë pushim. Nuk do ma prishni mua. Le ta gëzojmë edhe nesër bashkë!

Tafili s'u bë i gjallë.

* * *

Të pasnesërmen, kur akrepi i vogël i orës iu ngjit 9-s dhe i madhi shkau te 4-a, Tafili me Zelkon u gjendën në një nga sediliet e trenit të linjës së largët jugore. Tafili po kthehej përsëri në fshat.

Aty ndaj të errur, Tafil Bega me të shoqen dhe fëmijët hynë në rrugicën e fshatit. Ata dëgjuan një zhurmëri pune. Fshatarët po trasportonin pleh nga fshati tej te Livadhet e Gurrës. Tafili mori guximin dhe përshëndeti bashkëfshatarët. Disa heshtën, disa ia kthyen përgjigjen me gjysmë zëri.

— Po kjo kështu?! — foli si me vete Tafili.

— Epo mbase nuk na dëgjuan, se janë zënë me punë bota, o burrë!

— Ua, «Mbase, mbase!» Unë sokëlliva, kjo na thotë «mbase!» Ua «mbase!»

— Epo gjeje vetë, o burrë! — i tha Zelkoja.

Tafili, që ecte para saj nja dy hapa, nuk i ktheu përgjigje fare. Po Zelkoja tashmë kishte nisur t'ia lexonte mendimet që në fytyrë Tafilit të saj.

Te rrugica e mëhallës së tyre gati sa nuk u përplasën me Demon dhe Taren, të cilët, me ca kazma në krahë, kishin zënë gjithë rrugën që shkonte për nga kryesia e kooperativës.

— Si u erre, Demo? — foli i pari Tafili.

— ...!?

Demoja rregulloi mirë kazmat që mbante në krahë dhe nxori një kollë të thatë. Tarja nuk bëri zë fare. Afjon në fytyrë ishte bërë Tafili, po ta shihje atë çast.

— Kollu, Demo, kollu! Dhe të shkuara! — i foli tërë inat për të dytën herë bashkëfshatarit Tafili.

— Të shkuara ty, o Tafil! — ia ktheu Demoja, — se humbe nga puna për kaq kohë e s'u bëre i gjallë.

— Hëm! — ia bëri Tafili në vend të përgjigjes dhe vazhdoi rrugën për në shtëpi.

— Ishin kazmat e qilizmës, — tha Zelkoja, duke ngacmuar prushin më tej.

— E di ç'do të thuash! Atë që kishin shkruar në ballë të gjithë ata që gjetëm në punë.

Hynë në shtëpi. Zelkoja, e cila, zakonisht, sapo mbërrinim, merrej me rregullimin e fëmijëve, kësaj here, ndërsa po vishte rrobat e punës, porosiste Verën, të bijën, të kujdesej për të motrat.

— Është vonë tani, — foli Tafili, të cilin s'po e zinte vendi. Zelkoja s'iu përgjigj.

— Moj, po bllokadë do më bësh edhe ti, që s'fl et

29963 20234 BIBLIOTEKA E SHKOLLËS GJIROKASTËR



me gojë, apo si e ke hallin? — dhe shtoi: — Le që kjo mëri s'm'u nda as në Vlorë e as në Tiranë.

— Lëre shpatën e madhe, o Tafil! — tha Zelkoja dhe iu drejtua Verës:

— Dëgjo, xhan, hani byrek e pastaj në gjumë.

— Mirë, foli Vera, ndonëse udhëtimi e kishte lodhur.

— E di! — tha Zelkoja. — Unë...

— Ë po ç'presim?! — e ndërpreu Tafili që, si u ndërrua e mori në duar nja dy thasë të mëdhenj, ndoqi pas Zelkon, e cila me çape të nxituara mori rrugën nga sheshi i fshatit, ku punonin bashkëfshatarët.

Pa kaluar mirë rrugicën e tyre, Tafili mbajti këmbët.

— Se si më vjen, moj Zelko!

— Ja, sa të takojmë shokët, e pastaj do të ndihesh mirë, — iu përgjigj Zelkoja, që ecte përpara me të shpejtë.

PËR SOT E PËR MOT

Në të dalë të Dilanit, makina u fik. Shoferi i linjës, Sadushi, zbriti, hapi kofanon dhe, si gjithnjë, me buzë në gaz më tha:

— Mos u mërzit, letrar! — dhe, si mbaroi punë me defektin që e rregulloi aty për aty, duke fshirë duart me një leckë që e mori nën sedilien e tij, i qeshur vazhdoi:

— Duket që vini rrallë, se edhe makina bën naze, — dhe, që të mos më mbetej qejfi, më zgjati cigaren...

Ndërkohë makina mbërriti në qendër të fshatit dhe ndaloi te rrapi i madh. Rreth e rrotull tij plot njerëz, kush kureshtar për të ardhurit nga qyteti, kush priste të afërmit.

Megjithëse vetë jam nga fshati afër R-së, i njoh pothuajse të gjithë fshatarët e këtij fshati. Ndaj, kur vura këmbët në klub, u përshëndeta me shumë të njohur.

— Pse nuk shkruan një reportazh për kooperativën tonë, që të pesta fshatrat e saj i tufëzuan bagë-

titë qysh vjet në prill, po vete e na nxjerr bojën në gazetë me Tafilin, — më tha, duke më zgjatur kutinë e duhanit, Qenani.

— Ti, Qenan, flet nganjëherë si për pasnesër, — e ndërpreu Alush Mita pa më lënë kohë që të përgjigjesha. — E pse të ardhka më parë mbarë të shkruaj për fshatrat tona, kur tufëzimin e mbaroi gjithë rrethi?

— Oj, dreq! Po pse, a i vrarë, Tafilë mund të gjesh edhe të tjerë, po ja që ai shkroi për atë të fshatit tënë.

Dukej sheshit që u kishte mbetur qejfi, ndaj unë, për të treguar se kisha ende respekt për heroin tim, kur u ndava, u thashë shkoqur:

— Natën e mirë e bëfshi, se unë do të shkoj nga Tafili sonte.

— Natën e mirë, — ma kthyen njëzëri, — dhe pyete për tufëzimin, — dëgjova që pas zërin bubullimë të Alush Mitës.

Në shtëpinë e vogël dollmalie të Tafilit më priti vajza e tij, Vera.

— Urdhëroni! — dhe vrapoi të lajmërontë prindërit. Në derë u dha figura e gjatë dhe e qeshur e Tafilit. Dora imë nuk e kishte takuar ende dorën e tij, kur ai qëndroi një çast e tha:

— Të fortë jeni ju kalemxhinjtë. Të nxirrni në revistë, të bëni për ujët e gurrës, të merr vesh gjithë Shqipëria, si Çobo Rrapushin, e pastaj të vini në shtëpi për darkë si pa gjë të keq!

Nuk mund të rrija pa qeshur me revoltimin e heroit tim.

— Po çkemi atij qyteti, o shkrimtar, — ia nisi kuvendimit Tafil Bega.

— Nuk jam shkrimtar, o Tafil. Kështu që mos ma bëj qejfin kot.

— Qysh, ore, s'qenke shkrimtar?! Selfua ynë një vjershë kërreu në atë gazetën «Drita» dhe thotë: «Ne shkrimtarët duhet ta njohim mirë jetën, ndryshe thahemi si jonxha që mbolli kooperativa jonë afër spitalit të fshatit!»

Qesha pa të keq me thumbat e tij dhe akoma më shumë më bëhej qejfi pasi kuptova se në zemrën e tij nuk rëndonte maja e mprehtë e mërisë.

— E, që thua ti, shkrimtar, — vazhdoi Tafili taman sikur të ma kishte blerë mendimin që kisha në kokë, — gazeta e bëri punën e saj. Tafili futi sivjet 416 ditë pune, ndërsa Zelkua 330. Kështu që, nga unë nuk ke c'nxjerr asgjë dhe, domosdo që muhabetin do ta bëj «pa rezerva», siç thoni ju të qytetit.

— Po Zelkua si është, fëmijët si janë me mësime? Apo, meqë bëre 416 ditë pune, nuk pyet për të tjerët?!

— Sa për fëmijët, ata venë mirë, sidomos Vera, që na nderoi edhe në konkursin kombëtar të shëndetësisë, ku i dhanë një goxha diplomë... Pa, sa për Zelkon, aha, o shkrimtar... më mirë pyete vetë, — dhe, si hodhi njëherë sytë nga Zelkoja, që po hynte me kafet në dorë, e pyeti: — Hë, t'ia tregoj, moj Zelko?

Ajo, ashtu e skuqur në fytyrë, tha:

— Në daç edhe thuaja, por ama, ajo ka një vit që ka ndodhur.

— Nuk do të thotë gjë në kaloi një vit. Në t'u tha ty plaga aq shpejt, mahisjen mund ta kenë të tjerët, — dhe, pa e zgjatur, Tafili nisi të tregonte:

— Vjet, prilli nuk e kishte kapërcyer akoma javën e parë, kur në mbledhjen e gjithë fshatit u shtrua inisiativa e Pogonit të Gjirokastrës për tufëzimin e bagëtive të oborreve. Aty na u bënë të qarta si dielli që lind e si buka që hamë të mirat e mëdha që

kishte kjo punë. Pa na lehtësonte shumë familjen, sidomos gratë e fëmijët, pa na uleshin dëmet në bujqësi, pa mbrohej më mirë pasuria e kooperativës dhe vetë bagëtitë do të qenë më mirë. Në fund foli edhe sekretari i byrosë së partisë për kooperativën tonë, shoku Halil, që e sqaroi edhe një herë mirë e bukur këtë punë. Sa mbaroi shoku Halil, hop u ngrit Zelkua ime, si të kishte ndenjur mbi gjëmbaçë të mëdhenj. Shoqja Zelko, siç i thoshin ata të presidiumit, nuk priti as radhë as fjalë, po një të hequr thilenë: «Demek, t'ia japim kooperativës?! Pse nuk thoni kështu ju, po na e sillni rrotull? Unë për vete nuk i dorëzoj, ju po deshët eja e merrini!» – dhe u ul.

Mua m'u bë sikur më ra Këndrevica në çaçkë të kokës. Pa u ngrit i nxehur Pashuni, kryetari i kooperativës:

«Ne nuk marrim, shoqja Zelko, dhe, sa për atë që the për kooperativën, ajo nuk ka nevojë për bagëtitë e oborreve. Në rast se nuk ta mbush synë tufëzimi, thuaje troç. Më vonë do të bindesh edhe ti, por ama kucura në rrota mos na hidh kështu! Kështu, de!»

Zelkoja u ngrit për të dytën herë:

«Unë nuk hedh kucura, o kryetar, po thashë llafin tim, siç ma preu qypi, po ti ma more sëpraphi».

Unë hidhja ndonjë rreze shikimi nga Zelkoja. Ajo me kokë të ulur ishte bërë zeher dhe dëgjonte të shoqin pa thënë gjysmë fjale.

– Ndërhyri përsëri sekretari, që sqaroi edhe një herë problemin, po Zelkua ime sikur s'u ndje më. Pas kësaj, ç'të shikoje, o shkrimtar! U ngritën të gjithë: Aliu, Fatimeja, Jahua, Shyqua, Çufja... pothuaj tërë fshati dhe që të gjithë ishin dakord. Qëkurse Zelkua ime e shkrepi në hi në fillim të mbledhjes, mua m'u

ngjethën flokët e sharkut, prandaj në fund u ngrita vetë:

— Jam dakord familjarisht me iniciativën. Këtë punë e ka pleqëruar Partia. Sa për Zelkon, po nuk deshi sot, do dojë nesër, në mos le t'i marrë sa i takojnë dhe t'i kullotë vetë, mënjanë fshatit.

Pa e mbaruar unë mirë ligjëratën, u ngrit nënë Zuraja:

— Me leje, të them dhe unë plaka dy llafe? Ju kujtohet ca vjet të shkuar, kur u mblodhën këtu për punën e furrës në fshat? Të gjithë mblodhën turinjtë se na qe bërë mendja saç. Ca e ca nxirrnin mana për trahana: «Jo s'piqet mirë», «Jo s'kullon mirë» e ku e di unë se çfarë të tjera thanë. Por ama furra u hap dhe u mësuam me afshin dhe karvelet e saj, dhe neve grave na u zgjidhën duart nga saçi. Pa i flisni një çikë mendjes e kujtoni atë ditë kur u prish njëherë furra dhe na u nda mielli. Pa kujtoni që s'bëmë dot pa furrën e thoshim: «ku je, moj furrë karvele, ku je?» Kështu dhe kjo puna e bagëtive. Unë plaka kështu gjykoj, — dhe u ul nënë Zuraja.

— Unë, — vazhdonte Tafili, — nuk e mora vesh si arrita në shtëpi. Trupi më ziente si i shpuar nga gjilpërat dhe gurët e rrugës sikur qeshnin me mua. «S'të lë Zelkua të tufëzohen bagëtitë, o Tafil Bega, jo».

Pa e hapur mirë këtë muhabet në shtëpi, foli vajza, Vera: — Mami, e di ç'më thanë shoqet te dyqani i bukës? «Se mos jua shet mami dhentë në Këlcyrë nga meraku i tufëzimit!»

Atëherë nuk m'u durua më:

— E, moj grua, po ç'pate sonte? Dole kundër gjithë fshatit e na e bërë ujem këtë muhabet. Gjithmonë pas të tjerëve do të mbetemi ne? Në s'të mbushet

mendja, rri, pyet edhe bindu, por jo hop dhe në këmbë, sikur t'i hëngri cangadhet bisha!

Zelkua, si më vështroi me vëmendje, si njëherë e një kohë, tha:

— Për llafe ju të mbytni. Por ama harroni që vjen behari e kërkoni dhallë, kos e gjalpë. Nuk shkohet pa bulmet, Tafil, jo!

Unë e Vera ia dhamë të qeshurit. Kush ia kishte bërë gogol «tufëzimin?» Kushedi si e mendonte Zelkua ime tufëzimin, ndaj dhe e pyetëm: «Për kokë të fëmijëve, Zelko, nuk më thua, si e pandeh ti këtë punë?» — Po Zelkua e kishte gjetiu. Qe mësuar me to, t'i milte, t'i rregullonte me duart e saj e tani i vinte keq të ndahej prej tyre.

— Ku ka bërë vaki të mos rrah dybekun! Dhëntë e mia, e qumështin ta mjelë tjetri; unë vetëm të çoj kusinë! Nuk jam dakord. Si do bëj unë pa to!...

Tafili këtu ndërpreu tregimin dhe, si ngritëm gotat, pyeti të shoqen:

— Ta vazhdoj historinë, apo do e tregosh vetë?

Zelkoja, duke qeshur, por dhe e turpëruar, i tha:

— Vazhdo, vazhdo, vetëm fundin do them e vetë!

— E, që ta ngas muhabetin, shkrimtar vëllai, atëherë mua s'm'u duruа e t'i jap një tërsëllëm: «Po pse, moj, qeveria ndaj e bën tufëzimin, të thahet cingua jote për dhallë? Po kjo punë ju lehtëson juve, moj qyqe. Po ti, vetëm dëme, me këto të flamosura, ke paguar treqind lekë! Po pastërtia, moj, që të vijnë kakërdhitë brenda, nuk e mendon këtë, e? — S'i lashë gjë pa thënë. Në fund e vendosa vetë. Të dhjetë kokët do vemë në tufë që nesër, ti, fundja, merri ato dy kokë që të takojnë dhe ik kulloti vetëm në Dërstila.

Pa filluan stallat me punë vullnetare. Pa hodhën shtat dita ditës dhe u caktuan barinjtë e kullotat dhe

kjo punë erdhi dhe u lezetua, saqë në fund të prillit çdo gjë qe gati. Zelkua shikonte e shikonte po nuk fliste. Në 1 Maj u bë dorëzimi i bagëtive në tufë. Më sa fole ti që s'ishe, shkrimtar vëllai, aq foli edhe Zelkua atë ditë. Më pas s'pushoi. I pyeste çobanët dy herë dita: «Si e kam Bejkën? Ç'bën Syska? Si i kullotni? Ku i shpini për ujë?» E ku e di unë çfarë. Po do ti që edhe barinjtë filluan ta ngacmonin: «Aha, o Zelko, kjo puna e tufëzimit qenka pesë me hiç. Ato dhentë e tua as hanë e as pinë, as blegërijnë, vetëm thonë: «Shpjernani te Zelkua! Nuk rrimë dot me shoqe, na vjen turp, s'jemi mësuar!»...

Si i ngritëm gotat përsëri, Tafili vazhdoi:

— Një natë kthehesha nga qyteti dhe për më shkurt i rashë rrugës për nën stalla. Para meje shoh një hije që ecte nxituar. «Ç'të jetë», — thashë me vete dhe u dhashë këmbëve. Kur ç'të shoh! Zelko Bega, ime shoqe, me këpucët në dorë.

— Ku vete natën, si lugati? — i them. — Nga ishe?

— Te stallat, — ma ktheu me gjysmë zëri ime shoqe dhe shtoi: — I pashë në u kishin hedhur për të ngrënë, — dhe, si u mendua ca, vazhdoi: — Plot ua kishin shtruar, me jonxhë.

Që nga ajo natë Zelkua sikur u qetësua, po ne në shtëpi e ngacmonim. Zelkua qeshte dhe më lutej:

— Aman, Tafil, sé mos e tregosh në brigadë, se s'kam ku të vete nga turpi!

— Pse mos ta tregoj, — ia ktheja unë, — ti për interesin e «përgjithshëm» u ngrite natën, saqë të ra edhe tabani i këmbëve. — Ne qeshnim. Qeshte dhe vetë Zelkua.

Tafili, me sa duket, mbaroi historinë, ndaj mori gotat e tha:



— Epo gëzuar! Ta pimë këtë për tufëzimin dhe, më poshtë, historinë do ta thotë vetë Zelkua.

Ajo, si hodhi njëherë sytë nga vajzat e rregulloi cepat e shamisë, tha:

— E ç'ta vazhdoj më gjatë. Nuk kaloi shumë kohë dhe morëm qumështin e parë 120 kile e kështu radha ndiqte radhën si gurët në tespihe, tri-katër herë. Djathi, që ke në tavolinë, o mik, të të bëjë mirë, se nga ai e ke. Të na rrojë Partia, se së mbari i mendon të tëra gjërat. Partia i zgjidh të gjitha; për sot e për mot!

Tafil Bega preku me dorë buzën e gotës, e tha me zë të lartë:

— Të lumtë goja, moj gruaja ime!



«NGATËRRESTARI»

Çaf-çuf-çuf, dëgjohej zhurma e tastove të makinave të shkrimit në redaksi. Pa mbaruar diçka që kisha në dorë, më thirrën. Më kërkonte kryeredaktori...

Ne nxjerrim një revistë çdo muaj dhe na duhet shpesh të dalim me shërbim.

— ...Kështu! — i tha fund bisedës kryeredaktori. — Dhe mos harro, se tani është vala e fushatës së grurit. Mund të kapësh ndonjë aspekt apo dobësi, shpërdorime, dhe ndërto ndonjë fejton me probleme.

U ndamë. Po nisesha në drejtim të qytetit. E, për këtë punë, pasi revista kishte nevojë për një shkrim të tillë.

«Kjo punë jonë, — vrisja mendjen rrugës, — është si puna e gjahut. Shkon të gjuash. Godet që të ecën mirë dhe ke kënaqësi. Godet që kthehesh pa u nise dhe atëherë të shkon squfur. E kush të thotë: — Mëshehmua? Unë jam dembel. Jepi tani! Shkruaj!...»

Me këto mendime, që më bënë shoqëri gjatë rrugës, arrita në qytetin e vogël E, kur:

— E ku je, more Çeço, se humbe fare!

U ktheva rrëmbimthi. Ishte Nasi, shefi i bujqësisë dhe shoku im i kohës së studentllëkut, vite të shkuara.

— Shyqyr, — ia ktheva unë. — Ku jeni fshehur kështu?

— Janë të gjithë në aksion, — m'u përgjigj ai dhe vazhdoi: — Demek ke ardhur për ndonjë shkrim?

— Aty afër, — i thashë dhe i qava hallin se puna nuk më priste.

— Po do të dëgjosh Selimin, mbathja për në fshatin Divaj. Atje ke shoferin e kooperativës, që është «ngatërrestari» më i madh i fshatit në punë bujqësie. Shih e shkruaj! Qerim quhet, — dhe heshti.

Epo fati, me sa duket, po më ndihte.

* * *

Kisha qëndruar te dera e kryesisë, kur një kooperativist e vuri re sëkëlldinë time dhe më tha, pasi më pyeti se ç'kërkoja tek ajo derë:

— Në Lisaj e kam parë sot në mëngjes.

Ua hipa këmbëve për atje, i bindur se do ta gjeja.

— Ka ikur, — më thanë lisjotët, sa vura këmbën në fshatin e tyre. Pa shiko më mirë në lëmenjtë e Dervenit.

Po më vete squfur, mendova, duke u çapitur nëpër rrugë. Më mësuan targën e makinës së Qerimit dhe, sa e pashë tej në rrugë, me mendjen top thashë: «E kapa!» — Po m'u desh të bëja rrugë akoma sa të gjeja shoferin.

Duket ky Qerimi ç'mall është, sa e lë makinën rrugëve, mendova. Shkova te lëmenjtë.

Ai ishte sa një div, me gjoks të gjerë, thoshe se ishte rritur deteve.

— Më në fund u takuam, — i thashë, dhe prita si mbi gjëmba reagimin e tij.

— Ika, — ma ktheu Qerimi. — Jam në mes të fushatës e nuk kam nge, — e me dorën tërë kallo hoqi nga flokët disa kallëz gruri.

«Ky, — i dhashë zgjidhje qudisë sime, — ose është shtruar e mua më duhet të vë majat nga thembrat e t'ia mbaj nga erdha, ose është firaun i madh!»

— Në mos gabohem, — i thashë (duke ditur ca të dhëna të mjegullta për të), — gjithnjë s'ke qëndruar në një vend. Ishe për mrekulli në SMT-në e qytetit. E, ç'pate që fute këmbët arave?

Ai e kishte përgjigjen gati:

— Këtë e kam dëgjuar edhe një herë tjetër. «Ç't'u desh fshati, o lumëmadh, kur ke në xhep patentën e naftës dhe mund të marrësh një pagë të majme në park? — më tha një koleg imi. — Apo do të bredhësh arave e ugareve me makinë rrangallë?» — Po, ç'është e vërteta, unë di se ç'bëj dhe s'jam pishman.

— Po...

Ai s'më la të vazhdoja, po ma priti:

— Dëgjo, byrazer! Në ke ndër mend të bisedosh me mua, hip në makinë, pasi nuk kemi kohë. I thonë fushatë tani.

Pas kësaj nxitoi e hipi në makinë. Zuri sedilien dhe ndezi motorin.

S'e zgjata. U pa puna. Po kthehesha andej nga u nisa në krye të udhëtimit.

Në një sektor na dolën përpara ca fshatarë. Makina stopoi.

— Ku shkoni? — i pyeti shofer Qerimi.

— Në qytet, në E, — tha njëri me trasfë në sup.

— Hipni, — tha Qerimi prerë.

«Po ky sikur do të shkonte në Divaj! Të këputka në gënjeshtra ky», vazhdova hamendjet e mia.



Fshatarët hipën dhe sakaq makina mori përsëri udhën që të çonte në fushë.

— More shofer! — tha njëri prej tyre. — Ne jemi nisur për në qytet. Nga na shpie kështu?!...

Pashë nga Qerimi. Ai, pa frenuar makinën, nxori kokën nga kabina e me buzë në gaz u tha:

— Makina ime vetëm rrugën e fushës, të aravë e të fshatravë di. Është e sertë virania. S'më bindet të vijë në qytet. Nuk kam ç'ti bëj. Po ju për në qytet, ë? — Dhe shtoi: — Po korrjet, po shirjet e vaditjet, vjeljet, hamulloret e ku di unë sa, vetë do të bëhen ato? Unë kam siellë të rinj nga qyteti në fshat, por e kam për gjynah të madh të shpie të tjerë nga fshati në qytet.

* * *

Më së fundi mbërritëm në qëndrën e Divajt. Gjithë ditën e kisha kaluar në fushat e atij fshati. Atje u njoha edhe me «ngatërrestarin». Po sikur të shkruaja për të një fejton pozitiv? Po kryeredaktori çdo të thoshte? Në hotel, mendova, do të shfletoj... kujtesën, se shënime nuk mbajta. Fundja revista jonë i ka qejf «ngatërrestarë» të tillë...

NJERIU QË NUK HANTE BUKËN...

Para pak kohësh, në fshatin tonë ndodhi një histori për të qeshur. Duket kështu nga jashtë, të paktën për ne që e pamë, se, po ta marrësh hollë-hollë, historia është serioze.

Muajin që kaloi, në fshatin tonë erdhi një grup me pesë veta nga qyteti, për studimin dhe sistemimin e tokave. Të gjithë djem të dashur e punëtorë. Që në fillim u miqësuam me ta jo vetëm se ishin njerëz të mirë, po më tepër na lidhte zanati si bujq e ata nuk përtonin të na pyesnin për çdo pëllëmbë tokë të fshatit tonë.

Që ditën e parë filluan matjet, vendosën aparatet e, pasi pyetën mirë e mirë për emrat e arave, seç shënuan në një hartë të madhe.

— Mirëpo ditën e dytë në fshat u përhap fjala se njëri nga shokët e qytetit nuk e hante bukën! U shqetësuam të gjithë, pasi kjo po ndodhte me njërin nga miqtë tanë më të rinj, që kishte ardhur të na ndih-

BISKOTA
BISKOTA

monte me shkencën në fshat. Po bëheshin dy ditë dhe ne nuk dinim që miku i bujqve nuk kishte vënë bukë në gojë. Me ta marrë vesh, as neve nuk na shkoi buka në vend.

— Ç'të ketë, i ziu!?

Merza, shitësja e dyqanit ushqimor, na e preu:

— Mos ia qani hallin. S'ka një orë që sapo bleu tek unë pakon e gjashtë me biskota pesëlekëshe.

— More djem, shikojeni mirë këtë punë, se ka lënë shtëpi, katandi e ka ardhur të na ndihmojë ne, — na u drejtua xha Habili, ndërsa pleqtë e tjerë tymosnin çibukët.

— Nuk shkojmë të pyesim njëherë në mensë, — tha Coli i brigadës së perimeve. — Po sikur të mos jetë e vërtetë kjo historia e bukës?

Një të thënë e një të bërë. Sa e pyetëm Vitën e kuzhinës, na tha:

— Ata të tokave? Çdo vakt, fiks katër veta kanë ardhur.

— Po është edhe një, moj Vito, mos nuk e mban mend mirë?

— Paski qejf ju! — tha ajo. — Pa ikni tani, se do mpiks kosin! Unë kam frikë se mos pritet qumështi, ju kërkoni forcën.

— E, or, ju kam rixha, ne kemi hallin e njeriut, Vitua ka merakun e kosit. Po kësaj çi thonë, — tha xha Habili, që e ngiste ça si shumë Viton.

— Epo, u pa puna. or vëllezër, —u hodh e tha Coli. — Duhet marrë doktori. Mirë tha xha Hibili, mbase është i sëmurë.

— Mirë e ke ti, «piperkë» (Colit, ngaqë punon në brigadën e perimeve, i flisnim «piperkë»), po ti vetë the nuk duhet nxituar, — iu drejtua dikush.

— Thashë, o, thashë, por i biri i botës ka dy ditë pa bukë, pa!

— E, a të marrtë e mira, të marrtë, se edhe biskotat me brumë bëhen, — ia priti njëri me kunj.

Do ti, që kjo fjalë na bëri të mendohemi. Vërtet që ky shoku i qytetit kishte dy ditë pa vënë bukë në gojë, po biskota kishte ngrënë, ama!

Kjo sikur na lehtësoi, pasi menduam se mbase nuk ishte punë shëndeti. Nuk dinim se cili nga të pestë ishte ai që mbahej me biskota, megjithëse emrat ua dinim të gjithëve. E lamë që unë dhe xha Habili (si më i moshuar) të takonim në mbrëmje përgjegjësin e tyre dhe ta pyesnim, «si i brendshëm» që ishte, se kush nuk hante bukë, dhe pse. Se, ta themi faqe botës, fshatit tonë s'ia ka bërë vaki të mos i hajë njeri bukën...

Në mbrëmje trokitëm te dhoma e miqve. Na u lutën të futeshim brenda, po ne kërkuam me këmbëngulje Nekiun, përgjegjësin e tyre dhe, sa ngelëm vetëm, ai na pyeti i shqetësuar:

— Ç'ka ngjarë?! Mos keni gjë?!

Xha Habili, që është i rrahur në këso rastesh, i tha shtruar-shtruar:

— Jo, ne nuk kemi gjë, xhanëm, po për ju u bëmë ca merak.

Nekiut, që gjer atëherë priste me ankth, s'iu durua më:

— Pse, si qëndron puna? Ne jemi mirë...

Ndërkohë ne morëm frymë të lehtësuar.

— E po, aty ta ngas llafin, de, se ne silloiseshim si tepër, — ia priti xha Habili dhe, si heshti një çast, e pyeti mikun: — Ju jeni mirë, thua ti, po... njëri nga ju nuk ha bukë, ama!

Nekiut, përgjegjësit të grupit, i erdhi rëndë që fjala kishte marrë dhenë, por edhe për të qeshur i erdhi. Si heshti një copë herë në gjysmërrësirën para dhomës, u dha udhë mendimeve:

— E di kush «vuan» nga ne? — pyeti xha Habilin. — Ai që nuk e ha bukën është... Nesti, Nesti...

— Ai lastari i gjatë? — u sqarua xha Habili me padurim.

— Po, po, ai. Nuk e ha bukën, ngaqë është e misërt e nuk është mësuar me të.

— Ahaaa! — lëshuam një pasthirrmë të dy ne të fshatit se, të themi të drejtën, çoç na kishte vajtur mendja te kjo gjë.

— Ju e kuptoni tani. Nesti është rritur në qytet, ka ngrënë bukë të grunjtë. Po do ta «rregullojmë» edhe Nestin, apo jo, more Tare? — m'u drejtua mua Nekiu.

— Rëndësi ka që është mirë me shëndet, pa të tjerat... — u hodha unë.

— Ja, si na qenka puna! — tha xha Habili. — Kështu, nga boja, goxha është ai, — shtoi plaku. — Edhe në punë shquan. Po përsëri, more Neki, mua më duket se ai djalë është ca i sëmurë...

— Ai i sëmurë? — pyeti Nekiu, duke nënqeshur me kuptim.

— Po, po, ai. Po do ta hedhë. Do t'i kalojë, de, do t'i kalojë. Le që, për këtë përsëri do flasim, xhanëm. Po dëgjo këtu: nesër me ju nuk do të vijnë ata çunat që t'ju mbajnë dhogat.

— Aa, latat, — pyeti Nekiu.

— E, de, e. Do vij unë dhe ky mashkulli këtu, Tare Habili, — tha për mua.

Dhe kështu u ndamë atë natë.

* * *

Në fshatin tonë kishte bërë përshtypje mysafiri që nuk hante bukë. Kjo nuk e linte rehat as xha Habilin, të cilin e njohin të mëdhenj e të vegjël për njeri sedërli.

Të nesërmen e kuvendimit me Nekiun, gjithë ditën mbajta latat. Edhe xha Habili s'm'u nda arë më arë. Fare pranë punonin edhe brigadat e kooperativës sonë.

Me ne, si «usta» më i madh, punonte përgjegjës Nekiu. Po që të gjithë ata të grupit ishin punëtorë e fjalëpakë. Për këtë xha Habilit i pëlqenin shumë.

Duke shikuar nga Nesti, i cili punonte i përkulur mbi aparate, xha Habili më bëri shenjë për të parë edhe andej. Nesti herë pas here fuste njërën dorë në xhep, diç nxirrte andej dhe e afronte, pothuajse tinëz, në gojë.

— Filloi breitja e biskotave, — ngriti zërin qëllimisht xha Habili. Nesti, që kishte qëndruar ca më tej, e bëri veshin të shurdhër. Unë dhe Nekiu s'mund të mbanim gazin.

Aty nga dreka, kur mendja të shkon vetiu për bukë, xha Habili diçka i tha Nekiut. Kv, si bëri tri-katër herë «po» me kokë, na foli të gjithëve:

— Drekën do ta hamë poshtë, te rrapi i madh. Bashkë me brigadën e perimeve.

Të gjithëve u pëlqeu kv mendim, ndërsa Nesti u mat të thoshte diçka, po si duket ndërroi mendim dhe nuk foli.

Nga rrapi i madh, zërat e shakatë vinin deri te ne. Kur shkuam atje, na ftuan të hanim së bashku.

Filluam drekën edhe ne «të ekipit», siç na thërrisnin me shaka bashkëfshatarët. Ndërkohë hodha

sytë nga Habili, që e kisha pranë. Ai më shpoi me bërryl dhe bëri me sy përsëri nga Nesti, që gërmonte tokën me duar.

Atëherë xha Habili, si nxori një copë bukë misri e vuri ca gjalpë mbi të, i tha Nestit:

— O djalë! Merre këtë, se me gjalpë është!

— Falëminderit, xha Habil, po kam ngrënë.

— Mos ma kthe dorën, de, se është edhe me gjalpë, — këmbënguli xha Habili dhe shtoi: — Ndryshe, të kthehet nusja pastaj.

Të tjerët kthyen kokën duke qeshur. Coli «piperka», që e dinte sëkëlldinë e Nestit, tha më zë të lartë:

— Mirë, more vëlla, që ti thua se ke ngrënë, po si i bëhet që dyqani i biskotave ka qenë mbyllur gjithë ditën sot?!...

Të gjithë qeshën. Ndërsa Flora, brigadierja, iu drejtua me spond Nekiut:

— Ju cilat toka studioni për sistemim, shoku Neki, ato që prodhojnë vetëm grurë, apo edhe misër?

— Përzier, — tha gjithë duke qeshur Nekiu. — Pyethi Nestin për këtë, meqë ka në dorë edhe një studim.

Xha Habili mundohej të qëndronte serioz. Pastaj ia nisi përsëri me Nestin:

— Po merre një herë këtë, merre, se flori është e uruara, — dhe i zgjaste bukën me gjalpë.

— More Nesti, — shtoi pas pak, pasi vuri re hezitimin e tjetrit, — po ti vetë më ke thënë se yt atë në fshat ka lerë e është rritur. Dhe thekra e misri e kanë bërë burrë, apo jo?

Si heshti një copë herë, Nesti buzëqeshi i skuqur deri në majë të veshëve dhe tha:

— Ashtu është... por unë nuk e kam ngrënë ndonjëherë... dhe se si më duket... — dhe vazhdoi të hante copën me gjalpë i shtyrë nga çasti.

— Epo i ka «qytetërimi» këto. Po ne thamë se ishe bërë për spital, o i vrarë, që s'e haje këtë të uruar, — tha xha Habili jo pa kurajë. — Pastaj, — shtoi ai, ndërsa të tjerët dëgjonin, — tre muaj e kemi këtë misër të uruar dhe fillon e grunjta, ç'deshët që erdhët në këtë kohë?

Nesti hante dhe dëgjonte. Pa e mbaruar bukën, i tha xha Habilit:

— Po ju nuk mbajtët për vete, xha Habil...

— Ka xha Habili, ka. Më ka vënë plaka plot mua, plot.

— I ka vënë plaka rezerva, — u hodh Coli dhe të gjithë qeshëm me të madhe.

— Pusho, more «piperkë», pusho! — i tha Habili, duke tundur kokën e duke qeshur edhe vetë.

Atë ditë punuam deri vonë. Në mbrëmje «ekipi» u drejtua nga mensa e kooperativës. Në krye na printe xha Habili me Nestin. Xha Habili, që nga dera, i foli Vitos:

— Unë edhe Nesti e duam dopjo sot. Nekiun me Taren dhe të tjerët pyeti vetë.

— Erdha! — tha Vitoja e qeshur.

MATEMATIKA DHE... MULLARËT ME JONXHË

Letër e nxënësit Sabri Sakaj dërguar shokut të tij të ngushtë, SELFO SEFERIT, i cili mësonte në politeknikumin e qytetit:

I dashur shoku im i ngushtë, Selfo!

Këtë letër po ta shkruaj me mall, duke të uruar me një golik dashuri: shëndet dhe suksese për ta mbyllur klasën e tetë si gjithmonë, ashtu siç na thotë çdo orë mësimi mësuesi i matematikës, Hajrullahu, «me rendimente të larta».

Tani që po shkruaj, jam ulur si dikur bashkë, këtu në lëndinën e Kroit të Zogjve, ku manushaqet janë bërë për t'u korrur me drapër. Që këtej më kapi syri shkollën tonë të bukur, për të cilën ty me siguri të ka marrë malli, mapon e madhe të rrapi, si dhe vatrën e re të kulturës, që e inauguruam këtu e dhjetë ditë të shkuara.

SELFO vëllai!

Qëkurse ti, pas pushimeve të janarit, u largove nga fshati ynë, nuk mund të ta fsheh se më ka marrë malli por, siç e lamë bashkë atë ditë janari, kur

ne të përcollëm me shokët e klasës së tetë, letrat nuk do t'ia ndërpritnim njëri-tjetrit dhe në to do të tregonim ndonjë të re nga fshati a ndonjë qyfyr nga shkolla...

Ti Selfo, e di se në shkollën tonë kemi ndër mend të ngremë kabinetin e matematikës. Për këtë mësuesi ynë i matematikës Hajrullah Petro, ka dy muaj që silloiset dhe na flet për rëndësinë e madhe shkencore të këtij kabineti.

Një të premte mësuesi, i bërë paparune në fytyrë, hyri në klasën tonë i shoqëruar nga dy vetë, që zunë bankat e fundit. Morëm vesh se ishin inspektorë të seksionit të arsimit. Njëri prej inspektorëve, veshur me një xhakavento të zezë, i mori Agos librin e gjeometrisë dhe diç e pyeti.

Ndërkohë, mësuesi, si mori me një farë solemniteti mungesat, na tha:

— Në vazhdim të punës së pandërprerë, që po bëjmë për ngritjen e kabinetit të matematikës, temën e sotme të mësimit: Vëllimi i konit, siç jeni të lajmëruar që më parë, do ta zhvillojmë te Livadhet e Amullit të kooperativës sonë të Soficës,... atje ku ndodhen mullarët e jonxhës.

Sapo mësuesi mbaroi, ne vështruam njëri-tjetrin, duke mos e fshehur habinë. U çuditëm, Selfo vëllai, jo se nuk dinim ku binin Livadhet e Amullit, po na erdhi e papritur se s'qemë të lajmëruar. Pastaj, ç'ne në mars do të gjenim mullarët me jonxhë? Dhe hajde po deshe e mos i ngre supet deri te veshët nga habia... Të mos e zgjat, pas pak ne u rreshtuam para shkollës dhe filluam «marshimin» drejt Livadheve të Amullit. Vargun tonë e shoqëronin mysafirët. Kur kishim shkuar te mesi i rrugës, mësuesi na pyeti ne të radhëve të para:

— Kush ka metër në shtëpi?

U dëgjuan nja katër «unë», dhe Pëllumbi u shkëput nga rreshti e nisi vrapin për në shtëpi. Kthyem kokën pas. Dy inspektorët, që ecnin në fund, po bisedonin me njëri-tjetrin. Po u afroheshim Livadhevë, kur shoh të shkëputet nga vargu ynë Naile Hadua. Pyeta me sy Zihniun dhe më sqaroi se Naloja shkoi në shtëpi të merrte metrin-shirit për të matur lartësinë e mullarëve. «Paskan punë mullarët, — thashë me vete, — Selfo vëllai.»

Këto po mendoja rrugës, kur ndjeva që në sup më preku një dorë ledhatare. Ktheva kokën rrëmbimthi. Inspektori me xhakavento më buzëqeshi.

— E dinit që kishit mësim gjeometrie? — më pyeti.

— Po, — i thashë dhe shtova: — Orën e fundit.

— Po përse keni harruar mjetet, — më pyeti, — kur e dinit?

E ç'ti thosha unë, mor i dashur Selfo, ç'ti thosha mysafirit? Ne nuk na kishte lajmëruar njeri e, sa për mjetet, atëherë e morëm vesh.

Prandaj, me gjithë dëshirën time për t'u përgjigjur, e quajta më me vend të heshtja.

Inspektori, sikur ta kishte bërë mendimin tim, nuk më foli. Ndërkohë mësues Hajrullahu na kujtonte mënyrën e matjes së vëllimit të konit.

— Vëllimi i konit është i barabartë me një të tretën e sipërfaqes së bazës herë lartësinë.

Kishim arritur te Livadhet, po mullarë nuk na zuri syri gjëkundi. Në vend të tyre, si ca piketa gjigante ndodheshin të ngulur strumbullarët. Mësuesi diç tha me vete, pastaj e ngriti zërin:

— Po mullarët këtu kanë qenë gjithmonë... Interesant, ç'ti ketë gjetur...?! — Pastaj na shpërndau të gjithë në kërkim të tyre, po më kot.



— Me siguri jonxhën e kanë marrë për t'ua hedhur lopëve në stallat e Plevinës, — u hodh e tha Aqifi.

Mësuesi nuk foli, po vetëm shikoi nga të ardhurit.

Pas kësaj, more Selfo, shkuam me radhë nëpër të gjitha livadhet, po në vend të mullarëve qëndronin të ngulur dhe indiferentë strumbullarët.

Kërko mullar, e gjej strumbullar, kërko mullar, e gjej strumbullar, Selfo vëllai, derisa ora e gjashtë e mësimit na gjeti nëpër livadhe e kaçuba, të etur të matnim në natyrë vëllimin e konit.

— Erdhëm që erdhëm, — tha shoku im i bankës, Shemja, — meqenëse strumbullarët kanë formën e cilindrit, matim vëllimin e tyre... Ai ma tha mua për të qeshur, po me gjithë zhurmat e fushës mësuesi e dëgjoi.

— Punë që s'bëhet, — tha ai, — vetëkuptohet, nervoz i përmbajtur. — Strumbullarët nuk lidhen me prodhimin. — Dhe shtoi: — Punë që s'bëhet, formalizëm!

Të dy inspektorët vunë buzën në gaz duke përsëritur: «formalizëm!»

Në shkollë u kthyem vonë. Të ardhurit u drejtuan nga salla e mësuesve.

Mësuesi yné i ndiqte pas.

Ja, ngjarjen e mullarëve doja të ta tregoja, Selfo vëllai.

Të uroj suksese, shëndet e të mira!

Shoku yt i vjetër
Sabri Sakaj

Lofiee 10 mars 197...

DITËN E ENJTE

Në shkollën tonë e enjtja njihet si dita e mbledhjeve me prindërit. Është e vërtetë, pak a shumë, që neve mësuesve kujdestarë s'na durohet sa të vijnë këto mbledhje, pasi aty njihemi me prindërit, me të interesuarit direkt e indirekt. Këtu shikon lloj-lloj personash nga ata, që me siklet të madh kanë rezervuar pak kohë për të dashurit fëmijë e deri tek ata, që tepër të kujdesur interesohen për fëmijët, mbarëvajtjen e tyre.

Si mësues muzike, kam bërë përpjekje e kam derdhur djersë për përgatitjen e mbledhjeve me tema të veçanta. Mos u habitni, se edhe mbledhjet janë si një art më vete...

Ishin javët e para të vitit shkollor. Dhe ja, një të enjte po prisja prindërit. Mbledhja kishte rëndësi të dorës së parë. Dhe vërtet atë ditë, si rrallëherë, klasa qe mbushur me prindër. Me një fjalë mbledhja nuk bëhej me përfaqësi prindërish po me të gjithë prindërit e nxënësve. Rendi i ditës që kishim përcaktuar që



në mbledhjen e parë ishte: «Ku jemi me edukimin. Puna e të dyja palëve: mësues e prindër». Pra mbledhja që e rëndësishme. Pasi çela mbledhjen, unë u ula diku nga bangat e fundit dhe po dëgjoja me vëmendje oratorinë e një burri të bëshëm. Në fillim e mora për ndonjë të deleguar, pasi për herë të parë e shikoja

dhe e dëgjoja në klasë, ndonëse ai ishte viti i dytë që kisha nën kujdestari atë klasë.

— ...Por ka edhe raste të veçanta, që djali im nuk ka treguar edukatën që i japim në familje, apo ca më tej, edukatën e fisme, të trashëguar denbabaden në familjen e Xhokajve... Kështu, paska ndodhur, siç më keni njoftuar, që Landi, djali im (flas për vitin e kaluar), është ngatërruar me shokët, është indiferent dhe sivjet, këtu e një javë më parë, me një të goditur ka rrafshuar xhamin e mapos para shkollës! Nuk është vetëm puna e xhamit. Por ama mua më çudit fakti se ç'ka bërë shkolla. Nuk qenka kaq i zoti ky mësuesi i tij, sa ta edukojë me shije estetike?

Unë, sapo përmendi mbiemrin e familjes, e mora vesh ngatërresën. Fëmija i tij s'qe nxënës i klasës sime, prandaj desha të ndërhyja, po burri e kishte marrë me revan.

— Ç'kam bërë unë për edukimin e djalit? Domosdo që kam bërë shumë. E kam këshilluar, i kam folur në sy të gruas dhe veç syve të saj. Po ai? Edhe ai më ka pyetur: (Një parantezë, s'e kam hutaq djalin unë.) «Babi, të shkoj në kinema»? Dhe unë, që s'jam aq i cekët, sa mund të mendoni ju, nga ana pedagogjike, i kam folur me takt atëror. Në fillim i kam drejtuar grupin e parë të pyetjeve: Çfarë filmi është? Me luftë, pa luftë, apo me... dashuri (!)? Sepse edukimi është një çështje e ndërlikuar... Pastaj e pyes në thellësi: Me sa seri paraqitet ky film, me ngjyra, apo pa ngjyra; ka apo s'ka dokumentar, dhe shumë pyetje të kësaj natyre.

Unë, s'dija emrin e folësit dhe i drejtohem:

— Shoku... — Por ai as ma vuri veshin.

— Ju e dini që unë punoj në NIL Prodhime, — vazhdoi ai (Ne s'dinim asgjë!). — T'ju them të drejtën,

kam përgjegjësi: me planin, me mbledhjet, me shëtitimet, shtohen këtu edhe orët e punës vullnetare dhe mua s'më mbetet kohë e lirë (qoftë edhe të dielën), që të pyes për Landin tim. Le që të vjen ndonjë koleg e të thotë: «Shoku Paskal, si bëhet kjo?! Po ajo puna, u rregullua? Ç'thonë normimet?» — e deri në pyetje të tilla pa rëndësi: «A thua do të mbajë koha nesër, Paskal?» (Sikur të jem stacion meteorologjik!)

Ndërkohë, unë tentova përsëri të sqaroj «shokun Paskal» se kishte gabuar klasën, po ai, me dorën e ngritur në hapësirë, sikur të mbante fjalim, panegjirik, vazhdoi:

— Edhe gruan time, Vasilikën, e shqetëson së tepërmi çështja e Landit. Ka marrë vesh se djali ynë nuk e reflekton edukatën tonë. Bile mbrëmë nuk ka vënë gjë në gojë! Po mund të pyetni: Pse? Po si, more shokë, ka problem më proekupant sesa edukimi i djalit të vetëm? Dhe i biri i botës mu në mes të ditës të vjen me një copë kartë. «Djali juaj, filani, sillet keq. Edukata e tij na shqetëson. Ju presim në mbledhjen e sotme». Dhe unë erdha. Po nuk i thonë pak: Landi, nxënës i klasës së shtatë, shoku juaj i ngushtë dhe djali im, që ka marrë tri herë me radhë fletë lavdërimi në fillore, diskutohet sot për edukatë?....

Pas kësaj, klasën e mbuloi një pasthirrmë e gjatë. Si mësues kujdestar, në tërë atë zhurmë, më kot mundohesha të vendosja qetësinë. Një prind nga bangat e para e ngriti zërin.

— Po ne jemi klasa e gjashtë...!

Shoku Paskal, që ishte ulur, u çua i turbulluar:

— Më falni, por... dhe Landi im në këtë shkollë është... Pastaj, fundja, s'ka ndonjë gjë të jashtëzakon-

shme... dhe ai, para se të hidhej në të shtatën, në të gjashtën ka qenë.

«U duk puna», — thashë me vete dhe vendosa aty për aty ta shtyja mbledhjen për një ditë tjetër. Një gjë nuk kisha të qartë: Odisenë që kaloi derisa përfundoi në bankat e klasës sime. Së fundi, si për të marrë situatën në dorë, u çova dhe me dy fjalë thashë:

— Gëzohemi që shoku Paskal ia gjeti... derën shkollës. Mbledhjen mendoj ta vazhdojmë të enjten tjetër.

Prindërit, të lodhur e të mërzitur nga fjalimi i shokut Paskal, qenë dakord me propozimin tim.

SI PËRFUNDOVA NË... DREJTORI

Në shkollën tonë thonë se, kur kalon rrugës mësues Refati, pemëve u bien gjethet nëpër tokë nga frika. Refati është mësues i fizikës. Këtë gjë e di edhe vetë ai, që, për ta përforcuar këtë opinion, herë nxin si qielli i dhjetorit e herë shpërthen si shirat në vjeshtë.

Atë ditë kishim fizikë. Si zakonisht, këtë orë e prisja i trullosur. Pastaj unë jam ca, «esnaf» në fizikë... Sa ra zilja, me shpejtësi të pabesueshme më fluturuan të gjitha sackisha «përtypur». Më mbetën në mendje si jetime ca fjalë, po formulat... Ndërkaq, u desh një shtytje dhe një e kollitur pas derës, që në të gjithë të ngrinim kokat nga librat. Pas këtij sinjali mësues Refati u fut brenda.

— Bo, boo! — tha Selami nga banka e parë, — keq e paskemi sot!

Mësuesi mori regjistrin dhe po vinte nga rreshti ynë.

— Ashtu ëë?!.. domethënë ty të jepet për të shkruar?! S'e dija. As më kishte vajtur mendja. Na u rritën nxënësit.

Ngrita kokën, por ç'të shikoje! Mbi mua, si dy shigjeta të mprehta, ishin ngulur sytë e mësuesit.

«Po ky ç'ka», — thashë me vete.

— Apo jo, more shoku Kozma? (!)

— Urdhëro, profesor!... u çova në këmbë.

— Leri urdhëroni, djalosh, dhe më thuaj, për kë e ke fjalën në atë që ke shkruar në gazetë?

— Nuk ju kuptoj, shoku mësues. Ku e keni fjalën?

— S'më kupton, ë? E kam fjalën për atë shkrim kritik në gazetë. Po do ta shohim, — tha mësues Refati dhe, ashtu i gjatë, një pëllëmbë, e duke u lëkundur më tepër se zakonisht, doli nga klasa.

«Të jetë fjala për poezinë?» — thashë me vete. Isha kurioz ta lexoja (ose së paku t'i hidhja një sy). Kureshtja, që s'më linte dy minuta të qetë, më shtyu si me dorë deri në bibliotekë, te shoqja Minushe. Po shfletoja faqet e gazetës. Dhe ja, andej nga fundi i faqes së tretë, shikoj emrin tim poshtë një poezie satirike që ia pata dërguar gazetës disa kohë më parë. Poezinë e kisha titulluar «Mësuesi dhe formula». Poezia fliste për një mësues që i bënte formulat lëmsh dhe, në vend që të sqaronte mësimin, ta komplikonte edhe më shumë.

Të nesërmen, orën e dytë të mësimit, më kërkuan në kabinetin e fizikës. Aty u gjenda ballë për ballë me mësues Refatin. Ai ecte me lëvizje të ngadalta e nervoze, duke tundur dorën e majtë.

— Shumë mirë bëre që erdhe, — e mori fjalën ai. — Mua më informuan gabim, se ti na paske shkruar

vjershë e jo artikull. Po kjo s'ka rëndësi, — dhe shtoi: — Edhe unë kështu mendova, se do të vije, herët a vonë, për të kërkuar falje për atë vjershë, që të diskrediton si ty edhe ne mësuesit që kemi të bëjmë me formula. (Kuptova së, më në fund, e kishte lexuar vetë gazetën në fjalë). Prandaj, djalë i mbarë, është e udhës të kërkosh falje jo vetëm këtu, para meje, por edhe në sy të kolegëve të mi, për shembull në sallën e mësuesve.

— Nuk kam pse të kërkoj falje, shoku mësues.

— Si, si? Pa shih, na u bë më i rëndë bishti se sqepari... Po mirë, more djalë, për cilin mësues e ke pasur fjalën ti? Pa na thuaj!

— Për të gjithë ata mësues që vetë s'e realizojnë mirë përgatitjen dhe nxënësve u kërkojnë qindin...

— Domethënë nuk do ta tregosh emrin konkret, ë?

Unë ngrita supet në kuptimin «s'kam ç'të tregoj». Atëherë ai e flaku mbi tavolinë paketën DS, që rrotullonte në duar si të kishte tespihe, dhe tha në një mënyrë urdhëruese e kategorike:

— Mirë! Këtu jemi përsëri!

Këto ishin fjalët e ndarjes sonë. Po më kumbonin ende në vesh këto fjalë, kur u gjenda në korridorin e gjatë të shkollës. Ndërkohë, që pas shpatullave ndjeva një dorë që më rrahu lehtë dy-tri herë.

Ishte e drejtorit të shkollës sonë.

— Të lumtë, — më tha. — Urime për vjershën satirike. Më pëlqeu. Kishte humor të këndshëm dhe vlen edhe për ndonjë mësues të shkollës sonë, — vazhdoi drejtori, — madje do t'ua rekomandoj shoqërisht ta lexojnë.

Duke zbritur shkallët, ndiem hapa pas nesh. Ishte mësues Refati.

— E lexove poezinë e Kozmait, Refat? — e pyeti gjithë gaz drejtori.

—...!? Si? Jo!... Po, po... e lexova, — i turbulluar mezi bëri dy fjalë bashkë mësues Refati.

— Po nuk e di si do ta presin këta shokët që mërren me formula, Kozma, — tha drejtori me vështrim të ngulur te mësuesi.

— Mirë besoj, — iu përgjigja drejtorit.

— Po... Po, po,... mirë, — tha mësues Refati, ndërsa ne të dy vumë re të lexohej qartë turbullimi në ballin e mësuesit të fizikës.

RRËFIMI I NJË EDUKATOREJE

Kam plot katër vjet që e kam lënë shkollën ose, më thjesht, ajo më la mua në klasën e nëntë. Më përjashtim të fizkulturës, që kisha notë të mirë, në gjithë lëndët e tjera s'kisha pasur rastin të ndieja kënaqësinë e notave kaluese. Që nga kjo kohë, s'e vazhdova që s'e vazhdova shkollën.

E di edhe mendimin tuaj, po vazhdimi i shkollës së natës më dukej pa seriozitet dhe i sipërfaqshëm. Këtë e them me bindje, pasi kam edhe shembuj. Pastaj të tërë s'do të bëhen me shkollë, de. Babai vazhdimisht më thoshte të merrja gjimnazin, pa të lartën e shihte dhe ai që s'e gëlltitja dot. Por unë s'e shihja të udhës të ndiqja më shkollën.

Unë, Eli Gërxhuni, bija e Hilmies, vendosa të qëndroja në shtëpi. Ndonjëri mund të ngrejë supet se si mund ta zgjidhja vetë këtë mënyrë. Po, ç'të bësh, në shkollë s'doja të veja. Mësuesit i kisha tmerr. Merresha me pazarin ose psoninë aq, sa u specializova në zgjedhjen e sendeve.

Babai shpesh bënte sherr për «punën» time. Kur se nëna... eh, nëna! Ku ka si nëna! Sa herë që babai zinte në gojë shkollën, në shtëpinë tonë fillonin mbledhjet. Në fund të tyre, nëna mbaronte duelin kryesor me babanë, duke ia prerë shkurt:

— Na lodhe me këtë shkollën, de. Vajza s'deshi. E lëmë tani këtë llaf. Le që nuk e shikon Kozin e Nexhit? I rruat shkolla e bashkë me të edhe fshati, që e ka zënë e s'e lëshon.

Babai në shtëpi gríndej kështu, po në anën tjetër përpiqej të më siguronte ndonjë vend të mirë. Helbete, vajzë. Edhe nëna, që s'përtonte t'u qepej të tjerëve, e kishte në qendër të vëmendjes vendosjen time në punë, vetëkuptohej, jo në një punë dosido. — Puna e mirë sjell fat të mirë, — i thoshte shpesh babait. Dhe ja, një ditë më thirrën në një zyrë dhe më thanë se të nesërmen do të filloja punën si edukatore në një kopsht.

— Vajza e Hilmies? — më pyeti burri me syze.

— Po...

— Kaq mjafton. të tjerat i dimë, — më tha ai dhe, duke më dhënë dorën, kuptova se i dha fund bisedës. Ai, siç shpjegoi nëna më vonë, ishte baxhanak me një kushëririn tonë që jeton në Durrës. Kushëriri i Durrësit me familjen tonë është i ndarë nga një zjarr. Me dy fjalë, nëna dha konkluzionin në shtëpi:

— Gjaku mund të trashet, mund edhe të hollohet, por nuk bëhet ujë! — dhe iu kthye babait: — Ja, more burrë, si bëhen punët. Po ti e ngjite: «Shkollën që shkollën».

— Janë punëra në hava këto, moj grua, — dhe shtonte: — ke për ta parë.

Kisha ditë që kisha filluar punën si edukatore kopshti, dhe puna shkonte fjollë. Edhe sot, po të më shihnit me fëmijët, do të habiteshit. Kam arritur mjeshtëri në tregimin e përrallave, që nga ato me lugetër e deri tek ato me Nastradinin.

...Bile, nuk më harrohet një ditë me diell, kur kolopuçët e mi të zënë për dore, i mora para, drejt rru-

gës kryesore. Kishim shëtitje. Me vete mora pajimet e zakonshme: grepin për të punuar dantella. Duke kaluar përmes bulevardit, paçka se kishte trotuare, bëra të ndalonin me «respekt» dhjetëra makina. Në kthesën e rrugës, për habinë time, u dha kabina e një skode. E hutuar që një fëmijë shpëtoi për fije nga aksidenti, iu sula shoferit, i cili i hutuar me buzëqeshi:

— Gruas sate buzëqeshi ashtu!

* * *

S'shkoi shumë kohë, e u fol se mua do të më zëvendësonin me një tjetër, që kishte mbaruar shkollën për këtë punë. Nëna donte të thoshte se do të më çonin në klasën e parë për të dhënë mësim, por unë, qoftë edhe për modesti, nuk doja ta besoja. Megjithëse, po të më thërriste baxhanaku i kushëririt dhe të më thoshte se çështja duhej kuptuar drejt e se kjo qe një detyrë që duhej kryer, unë s'do të mund ta kundërshtoja.

Mirëpo s'ndodhi ashtu.

— Duhet një shoqe me shkollë, — më thanë.

— Po unë, ç'të bëj? — pyeta drejtoreshën.

— Në prodhim, — ma preu ajo, — vazhdo edhe shkollën.

Desha s'desha, ia dëgjova këshillën. Sot, që kanë kaluar disa vite, ia di për nder asaj drejtoreshës sepse, po të mos kishte folur ajo, mbase edhe sot e kësaj dite nëntë klasë do të kisha.

VJEDHËSI I VITEVE

Me mendimin që i erdhi në kokë, Sako Saçi vendosi t'u tregonte bashkëqytetarëve se nuk është i zoti vetëm në zanatin e tij, po shquhet edhe për hesapë të tjera.

S'i ka kaluar të pesëdhjetepesat, po vitin e kaluar e zuri një sikletë, që për net me radhë s'vuri gjumë në sy. Pas këtyre netve, iu duk sikur e zgjidhi lëmshin e madh që nuk e linte të qetë...

— E gjeta! — tha, duke i rënë tryezës me grusht. Ndërsa gruaja, që rrinte përbri tij, duke bërë dy hapa pas, nga frika, desh ra. Megjithëkëtë, s'e kuptoi si qëndronte puna. Sakja vendosi t'i tregonte tërë pompozitet:

— Shoqja Zyhra, edhe pesë vjet i duhen Sakos tënd të dalë në pension!

Zyhraja, e habitur, e dinte se atij i duheshin jo pesë, po dhjetë vjet të tjerë punë. Vërtet moshën e arrinte, po s'kishte vjetërsi. «Megjithatë... s'dihet. Punë dokumentash», mendoi. Po Sako Saçi, i njohur si

normist prej shumë vjetësh në qytetin tonë të vogël, kishte të tjera mendime.

«S'ka gjë tjetër veçse së mirës këtu. Demek, do të hap gjyq. Pa do të fitoj nja katër vjet vjetërsi pune. E si, do të thotë bota? Pa do të gjejë dëshmitarë Sako Saçi, jo shaka!...»

Dhe me laps në dorë filloi hesapet... I dolën plot shtatëmbëdhjetë vjet punë shteti, që nga viti 1957. Për këto vite, Sakoja qe i qetë, se ato preheshin në librezën e punës, po sikleti ishte gjetkë, «si mund të hynin në librezë edhe katër vjet, para 1957-s, kur kishte punuar si privat dhe kur lekët i fuste me të dyja duart në xhep?»

«S'bëhet nami, — i fliste vetes, — të hedhësh në librezë vetëm katër vjet. Katër janë, de. Fundja lekët e shtetit dhe ujët e detit s'kanë të sosur!»

Ndërkohë, në qytetin e vogël u hap fjala se Sako Saçi po merrej me letërsi. Për herë të parë në moshë madhore Sako Saçi shkeli në bibliotekë.

«Nejse, më mirë që u vete mendja për letërsi!»... — tha me vete Sako Saçi, pasi mori vesh hamendjet. Mbase kishte të drejtë qyteti që fliste për leximet e tij po, ç'është e vërteta, Sakoja nuk lexonte në sallë as vjersha as romane, po gjetkë e kishte hallin. Donte të dinte ligjin: «Mbi sigurimet shoqërore shtetërore të RPSSH», si dhe kapitullin «Pocedura civile».

Pasi i gjeti, i shkroi në një copë letër tërë zell. Një kopje të këtij dokumenti Sakoja e mbante te komodina pranë krevatit.

Përveç të tjerave, ligji thoshte se, për të vërtetuar vjetërsinë, duheshin prova ose dëshmitarë. Dhe barra e provës i binte paditësit, me një fjalë Sako Saçit. Vërtet Sakoja nuk kishte prova, por ama do të gjente

dëshmitarë, me të cilët do të elektrizonte sallën dhe do të gozhdonte trupin gjykues. E, kur i mbushej mendja Sakos për diçka, zor se e ktheje.

* * *

Ditët rrodhën dhe dita e gjyqit erdhi. Sakoja kishte zënë vend në sallën e gjyqit. Në ballë trupi gjykues. Ja dhe përfaqësuesi i sigurimeve shoqërore. Pranë Sako Saçit rrinin dëshmitarët dhe nëpër stola kureshtarët. Gjykatësi lexon «Kërkesëpadinë» e shokut Sako:

«...Unë i nënshkruari Sako Minush Saçi, për efekt pensioni, kërkoj të provoj gjyqësisht se gjatë periudhës 1953-1956 kam punuar në mirëmbajtjen rrugaura, në sektorin Likaj të këtij qyteti... Gjatë kësaj kohe kam punuar si punëtor i thjeshtë krahu (pa pretendime). Faktet i provoj me këta dëshmitarë: Pilo Pilurin dhe Stefan Pellushin.

Dëshmitari i parë. Sakoja rri si mbi gjemba. Fillon edhe Piloja:

— E njoh shokun Sako në këto vite, pikërisht e personalisht. Unë, me të kam punuar dy vjet... Pastaj Sakoja iku në sektor tjetër... po s'më kujtohet dhe aq mirë...

Gjykatësi aprovon me kokë, përfaqësuesi i sigurimeve shoqërore shtetërore sikur buzëqesh me vete. Kjo nuk i pëlqen Sakos.

Salla dhe Sakoja. Përfaqësuesi i sigurimeve shoqërore, pasi merr leje nga trupi gjykues, i bën një pyetje padëshirë Sakos, sikur të jetë anëtar i një komisioni provimi.

— A mund të më sqarosh mua dhe shokët gjyqtarë, si ka mundësi të keni punuar në këtë kantier në vitet 1953-1956, kur ky është ngritur në qytetin tonë vetëm në vitin 1955?!

Sakoja e mallkoi me vete me rrënjë e me degë për këtë «pakujdesi». dhe mundi të belbëzojë:

— ...!? A... është i sigurt shoku i sigurimeve shoqërore?

— Po, shokë gjyqtarë. Më lejoni t'ju paraqes si provë vendimin e dikasterit qendror.

Heshtje. Tani Sakon e pushtoi hutimi. stepet dhe nuk i tregon më duart. Dhe gjithë salla. ştolat. gjyqtarët dhe ata... dëshmitarë sikur po i sillen rrotull. Ja edhe dëshmitari tjetër.. Të njëjtat fjalë. e njëjta formulë. Sakos gjithë fjalitë që dëgjoi iu bënë ujem.

— ...Me Sakon kam punuar në vitin 1953-1956 në rruga-ura.

Gjyqtari në krah të djathtë të kryetarit të seancës i drejton një pyetje (Ah. këto pyetje. që i bien si çekan në kokë Sakos!).

— Po mirë. dëshmitar Stefani. ju në këtë periudhë keni qenë ushtar në Kukës dhe... a mund të na e shpjegoni këtë kontradiktë?

Kjo sikur e godet mu në zemër. atje ku mban fibrezën e punës. Sako Saçin.

...Dhe jepet vendimi:

— ...Kërkesëpadija e Sako Minush Sacit rrëzohet... (vjetërsia fitohet me punë). — Si heshtë pak, gjyqtari vazhdoi me vështrim nga dëshmitarët e rremë: — Ndërsa për ata që deponojnë dëshmi të rremë, ligji do ta thotë fjalën e vet...

Salla vazhdon të rrotullohet në mendjen e Sakos. Ai nuk flet më, ndërsa libreza e punës sikur i djeg atje në xhep.

BURRI IM DASHURON... FUTBOLLIN!

Duke ndryshuar emrin tim dhe të burrit, vendosa të shkruaj këtë tregim, e shtyrë dhe nga të tjerë, jo për arsye letrare, po për tjetër hall...

Ngjarjet fillojnë në shtator dhe mbarojnë kur mbaron edhe sesioni i futbollit! Katërmbëdhjetë javë djersë e mund në stadium, po kaq grindje e gëzim në familje...

Po më mirë le të tregojmë ngjarjet me radhë. Qysh para shtatorit ne fillojmë të përgatitim fëmijët për në shkollë — jo përparëset, librat, fletoret... Po kush merret me këto, thoni ju? Unë, Vojsava, se burri ka përgatitjet e tij — siguron kalendarin e futbollit, ndjek stërvitjen e ekipit, takohet me trajnerët, shkon e pyet magazinierin e klubit sportiv për ngjyrën e bluzave të futbollistëve, e të tjera halle të tilla.

— Genci, — i thashë një ditë para fillimit të shkollës, — nesër fillon shkolla.

— Çudi, grua, këtë javë fillon edhe kampionati! Çfarë koincidence! — shprehu habinë ai, duke shfletuar kalendarin e futbollit.



Të dielën e parë të shtatorit, familja jonë pati festë të vërtetë. U ftuan gjithë komshinjtë dhe të njohurit e Gencit. Çfarë nuk u vu në tryezë. Dhe të gjitha i bleu e i përgatiti vetë Genci.

Ekipi i qytetit tonë fitoi ndeshjen e parë të kampionatit, e cila na kushtoi një dreq e gjysmë! Llogaritni, ju lutem, sikur skuadra e zemrës së burrit tim të fitonte çdo javë?! A kam të drejtë të uroj që kjo të ishte fitorja e parë dhe e fundit?

Dhe vërtet, fill pas kësaj darke, filluan humbjet, që unë i ëndërroja aq shumë; po kjo ishte ç'ishte! Gencit i nisën dhimbjet e kokës, u bë grindavec, fjalaman dhe pothuaj oreksi iu pre fare.

Megjithëse kishin kaluar pesë javë, ekipi ynë i futbollit kënaqej me dy pikët e shtatorit. Burri im çdo mbrëmje përllogariste në një fletore të veçantë, klasifikimin e skuadrave, duke parashikuar fitoret e mundshme të skuadrës së tij.

— Babi, — iu afrua një mbrëmje djali ynë i vogël, që ka hyrë në klasën e parë, — si bëhet dyshi?

— Çfarë dyshi, or gdhë? Nuk ka dysh fare! — qe përgjigjja e tifozit të familjes sonë, i cili, duke lidhur pyetjen me gjendjen e skuadrës në klasifikim, e mohonte fare këtë shifër. Atëherë unë, për inat, iu afrova Benit të vogël me «Sportin popullor» në dorë dhe i tregova dyshin që qëndronte përbri skuadrës sonë.

— Ja dyshi, xhani i mamit, ja. E sheh si e ka nënvizuar babi?

Të mërkurën i thashë Gencit:

— Nesër, të enjten, në shkollë kanë takim me prindërit e, meqenëse unë do të jem në mbledhjen e zgjeruar të ndërmarrjes, do të shkosh ti.

— S'bëhet kjo, grua! Të enjten pasdite skuadra ka

ndeshjen e kontrollit. Ti e di vetë që nuk rri pa e parë... ndaj...

— Po më rëndësi ka ndeshja jote, nga shkolla e fëmijëve tanë? — e pyeta për ta detyruar Gencin, duke ndier një zemërim të vakët.

— Interesi i përgjithshëm mbi atë personal, shoqja Vojsavë! — e, duke tundur kalendarin blu para syve, vazhdoi: — Skuadra është e gjithë qytetit.

Kështu, të enjten asnjëri nga ne nuk u bë i gjallë në mbledhjen e prindërve.

* * *

Në shtëpinë tonë s'bëhej bisedë tjetër përveç futbollit. Vinin komshinj apo farefis për vizitë, Genci, pa u ulur mirë të ardhurit, fillonte:

— Aman ndeshje, ë?... Po ç't'i bësh, kur s'ke portier... — Aq dendur ndodhte kjo, saqë një mbrëmje kunati im e vëllai i tij, Fredi, i cili kishte ardhur te ne për vizitë me të shoqen, ia priti:

— Më ngadalë, o Genc, se në vend të na thuash: «Mirë se erdhët!» na thua: «Ç'penallti e bukur!!»

Të dielave zor se e gjeje në shtëpi, pasi s'i ndahej skuadrës. Edhe kur ajo luante jashtë rrethit, Genci pas saj.

«Jam tifoz operativ unë, — thoshte me mburrje kur e ngacmonin shokët, — nuk i ndahem skuadrës edhe në ditë të këqija!»

— Skuadrës vërtet nuk i ndahesh, por po ndahesh me familjen, shoku Genc! — ia ktheja unë dhe filloja të numëroja gjithë të këqijat që po na sillte tifozllëku i tij «operativ». Edhe fëmijët sikur filluan të

mbanin qëndrim. Po ku pyeste Genci! Vinte i vëllai, kushërinjtë e të gjithë i flisnin, po burri im, duke tundur kalendarin, përgjigjej:

— E kam pasion, nuk mundem.

Kështu vazhdoi gjendja deri javën që shkoi, pasi më vonë ndodhën ca ngjarje, të cilat tronditën pasionin e madh të Gencit.

Të dielën që kaloi, burri im nuk ishte në shtëpi, pasi «skuadra e zemrës» luante në qytetin fqinj. (Madje Genci shkoi që të shtunën pasdite, ndonëse mund të vente me tren dy orë para ndeshjes). Të dielën në darkë prisnim tifozin të kthehej.

Ora po kalonte, ai akoma nuk po dukej. Pyetëm nëpër komshinjtë. Po na thanë se, meqë skuadra jonë kishte fituar, ishte e kuptueshme që Genci të vonohej. Në fillim menduam se do të ishte kthyer për të bërë pazar, pasi do të festonin «kthesën e madhe», po kur kaloi ora dhjetë e natës e u bindëm se festë s'do të bëhej, filluam të shqetësoheshim... Një orë më vonë hyri në shtëpi i këputur. Dukej i sëmurë, digjej flakë dhe fliste vetëm me shenja. Lajmëruam urgjencën. Mjeku, si e vizitoi, duke qeshur tha:

— Ju, mos jeni tifoz?

I sëmuri, me një buzëqeshje tërë lumturi, që mjeku e kishte kuptuar, pohoi me shenja.

— E qartë! — konkludoi mjeku dhe, duke m'u drejtuar mua, vazhdoi: — Burri juaj s'ka gjë shqetësuese. Në qoftë se më lejohet të shprehem kështu, nën ndikimin e situatave futbollistike në stadium, ka bërtitur, është çjerrë, më vonë ka zhveshur xhaketën. Në këto rrethana, është ftohur. Grykët i janë skuqur, ka temperaturë. Urdhëroni recetën, — kaq tha mjeku, duke u ngritur të ikte.

Genci sikur u skuq më tepër dhe nuk fliste as me shenja.

Kuptohet, që të nesërmen u bë më mirë, po për punë nuk ishte.

Në pasditen e së hënës, në derë u dëgjuan tri trokitje. Ishin të dërguar nga organizata e Frontit në lagje. Sipas zakonit, i çova miqtë në dhomën e pritjes, megjithëse ata këmbëngulën me njerëzillëk se nuk do të qëndronin gjatë. Kureshtjes sime për këtë vizitë ia zuri vendin habia kur ata më thanë se erdhën vetëm për burrin tim Gencin dhe sakaq pyetën për të. Atëherë u tregova se ndodhej matanë i sëmurë, e i ftova për në dhomën tjetër. Genci u dha dorën dhe ata i uruan «të shkuara». Ai miratoi me kokë, sikur të thoshte: «dakord jam me ju», po zë, me gjithë dëshirën e madhe, kuptohet se nuk nxori.

— Të na falni, që erdhëm në këto çaste, — tha njëri prej tyre, — po nuk do të ishte keq ta pleqëronim problemin që na shqetëson.

Burri im, me vëmendjen e përqendruar tek ai që fliste, më dukej si para provimit.

Ndërkohë i dërguari vazhdoi:

— Në adresën e Frontit të lagjes, ditët e fundit ka ardhur një letër. Atë e dërgon administrata e stadiumit të qytetit tonë.

Genci e rregulloi përsëri jastëkun e qëndisur dhe priti me një farë ankthi në zemër.

— Aty flitet për një problem tepër serioz. Flitet për disa qytetarët tanë, që demonstrojnë në stadium një tifozllëk që shqetëson të tjerët.

Fytyra e Gencit ndërronte vazhdimisht ngjyrë, herë skuqej e herë zverdhej.

— Ne, — e mori fjalën një grua nga të grupit, — nuk do të kishim ardhur te ju, shoku Genc, sikur

emri juaj të mos qé në vendin e parë të listës. — Unë heshtja, duke pritur që të fliste burri, po shpejt u kujtova që ai nuk fliste dot, ndaj thashë në këmbë të tij:

— Ju falemi nderit! Shumë e drejtë, shokë të Frontit. Kjo nuk do të ndodhë më.

Këto i thashë duke mos ia ndarë sytë Gencit dhe ndjeva një lehtësi të madhe, kur edhe ai me gjeste miratoi gjithë sa thashë.

Të nesërmen e kësaj dite burri im shkoi në punë.

Ditët e tjera rrallë fliste për sportin në shtëpi. Interesin për ndeshjet nuk e humbi e as kalendarin sportiv, që mbante me vete, nuk e hodhi, po stuhia e pasionit të mëparshëm sikur iu fashit.

Ai nuk e hapte më në praninë time të famshmin kalendar sportiv e nga të gjitha këto më bëhej zemra mal, se «i sëmuri» im po e merrte veten.

NJË TELEGRAM

— Zydi, një telegram... — dhe dikush i zgjati dorën.

Zydiut, përgjegjësit të sektorit në A., që e kishin dërguar për ca ditë me punë në Sukth, i rreh zemra fort. Kur u largua nga qyteti i tij, gruan e kishte lënë në siklet të madh. Priste fëmijën e parë.

Po puna ka rregullat e saj...

Fytyra iu bë blana-blana të kuqe e të verdha. Lexon tekstin e plotë.

... DRITA... TË FALA DHE TË RRONI VETË!...

Zydiu stepet. Duart i dridhen dhe s'është në gjendje për asgjë.

Këmbët e çojnë nga stacioni i trenit për në qytetin T, për në maternitet. Ai priste tjetër telegram nga e kunata. Por... ja që jeta paska dhe të tilla. Ndihet i lodhur tej mase, aq sa i duket se s'do të mbërrijë dot në T. «Kush ka ndërruar jetë, vallë, ajo, Drita, apo kolopuçi?! «Kjo pyetje e torturonte

Zydiun dhe ndiente sytë t'i digjnin. Kishte marrë pjesë në hidhërime të ndryshme, qe hidhëruar përtë tjerë, por... As vetë s'e kuptonte se si këmbët i lëviznin, e ai, me një ide fikse, ecte drejt maternitetit, pa ua vënë vështin përplasjeve të shpeshta me kalimtarët, që e shikonin të çuditur.

Ndërkohë arriti në maternitet. Te hyrja priste e kunata tërë gaz. «Po kjo?! Mos i ka bërë mendja fap, ose mua m'u prishën sytë». Por jo.

— Zydi, urime! T'ju rrojë! — thotë ajo tërë gaz. — Po ç'ke kështu? Apo doje djalë, ëë?...

E Zydiu, i dërrmuar lëshohet te shkallët e maternitetit. Dhjetëra sy grash e vajzash të moshave të ndryshme e shpojnë me shikime kureshtare.

— Domethënë gjallë?... — fillon e çelet Zydiu.

— Ç'thua, mo, ç'janë këto fjalë?

— Këto, — thotë Zydiu dhe i zgjat telegramin.

Rrudhat thellohen në ballin e së kunatës, pastaj në faqe dhe në fytyrë i ndehet trishtimi.

— Paske të drejtë, mo i uruar. Po Dritën dhe vajzën i ke plot shëndet. — Flet dhe qesh e kunata, ndërsa ai do të bisedojë me Dritën dhe merr guximin e hyn te dera e madhe.

Nuk i thonë pak. Ajo ishte bërë viktimë e ndonjë centralisteje që kishte improvizuar goxha tekst.

JAKJA QË S'TA MBUSH SYRIN

Kur u paraqita në kuadër për të nisur punën, punonjësi i kuadrit më tha për në minierë.

— Do të punosh në brigadën e Jakes, — dhe, si më dha një shënim për rrobat e punës, vazhdoi:

— Dhe kujdes, se me Jaken s'ka shaka!

Aty për aty më lindi mendimi se ky, Jakja, që më sa dukej ishte brigadier, me siguri duhej të qe njeri shumë i ashpër. «Hajde, shans, hajde, — thashë. — Pa le në e marrtë vesh se në fillim nuk doja të punoja në minierë!»

Të nesërmen fillova, sipas rregullave, instruktimin. Për habinë time, brigadieri nuk quhej Jake, po Hajri. Unë, durova sa durova, po, kur hymë në galerinë kryesore fola!

— Pse, nuk quhesh Jake ti?

Brigadieri, një burrë i gjatë shpatullgjerë, vuri buzën në gaz dhe tha:

— Unë quhem Hajri Beqiri. Jakja është minatori i frontit ku do të punosh ti, po këto ditë ai nuk është

në minierë; është në stërvitje ushtarake, — dhe, pasi ecëm edhe pak, shtoi: — Po mos u mërzit, se do të njihesh edhe me Jaken.

Në zërin e brigadierit, kur përmendi emrin e Jakes, ndjeva një krenari.

Ditët e instruktimit ndoqën njëra-tjerën dhe unë fillova nga puna. Fronti ynë kishte disa ditë që jepte 6-7 vagonë më pak se plani.

— Ku do vemi nga Jakja, o shokë, — na tha një ditë fugisti i frontit tonë, Adili. — S'ka turp më të madh për ne. Kemi 10 ditë që nuk po realizojmë planin.

Dhe kështu, çdo bisedë mua më dukej se lidhej me Jaken, thua sikur të qe babai i minierës. Ditën e njëmbëdhjetë, kur mbaroi turni, shefi i sektorit na tha:

— Përsëri 10 Vagonë minus ju ë? Ikni kërkoni Jaken në zbor, mbase na e jep komanda... — Dhe shtoi duke qeshur: — S'keni kocka për planin ju, jo!

Unë ende s'po kuptoja gjë. «Kaq i zoti të qe ky Jakja»? Dhe para syve të mi dilte një minator i gjatë dy metra, shpatullgjerë, fjalëpakë, fytyrëashpër, me ca duar të fuqishme si të Mujit, me të cilat mbante pistoletën 22 kg. Pistoleta në duart e tij më ngjante si një lodër fëmije që e shikojmë në vitrinat e kinkalerive. Atëherë thosha si për të vërtetuar hamendjet e mia: «Jakja do të jetë kollos». Këtë mendim një ditë e thashë me zë.

«Është luani i minierës. I ka shokët të rrallë», më thanë shokët e frontit.

Juve mbase nuk ju besohet, po në mendjen time Jakja zuri një vend të veçante e mezi prisja të kthehej nga zbori.

Ditën e tetëmbëdhjetë të punës u futa më herët

në front, ndërsa shokët e tjerë do të zbrisnin nga sipër (siç i themi ne daljes së dytë të llavës). Sa ishin hedhur minat e para e unë po mbushja vagonin e shtatë, kur shoh të zbresë nga llava një dritë. Afroj llambën te sytë të njoh të ardhurin; ai më kishte kthyer krahët e shikonte vagonët e mbushur. Pastaj, duke u afruar, dëgjoj të më flasë:

— O-o, të lumtë, babush! Të lumtë, për nder! Ç'janë këta vagonë përgjysmë?! Ke frikë se mos thyhen në mes nga qymyri, ëë, ndaj nuk i mbush në nivel?! Hajde, të kursyer, hajde! I thua dhe vetes minator, pa le!

M'u duk sikur vërshoi mbi mua një rrëke uji e ftohtë.

— Shoku inxh... — desha të justifikohesha se vagonët s'ishin përgjysmë, po vetëm katër gisht nën nivel.

— E di, e di ç'do më thuash! — ma preu ai mendimin, — nuk janë përgjysmë, po katër gisht qymyr bosh! E shoh, o hesapxhi, e shoh. Po të shtatë vagonët që ke mbushur «në buzë», me katër gisht bosh, bëjnë pesë pëllëmbë, e pesë pëllëmbë bëjnë gjysmë vagoni, o babush. Po, meqë ditke hesape, nuk ma llogarit, sikur të gjithë vagonistët t'i hanin planit nga katër gisht, sa i ha miniera shtetit?! Hë, o babush, fol!

Po më sa folën vagonët me qymyr, aq fola dhe unë.

— Kështu, shok — përfundoi ai. — Dhe, që ta dish, nuk jam inxhinier unë. Jam Jakja.

Mua m'u ftohën rrobat në trup. Si ka mundësi të jetë ky Jakja? Kjo pyetje m'u ngul si një gozhdë në mendje. Para meje qëndronte një burrë mesatar, eshtak nga trupi. Vura re se i rrëmbeja ndonjë pëllëmbë nga gjatësia e nga gjerësia. Për ama, sytë i kishte

shpuzë e gjuhën brisk. Koka mezi i dukej në kapelen e minatorit, ndërsa duart e vogla goditnin me forcë mbi vagon. «E pamundur, — thashë me vete! — Ky njeri as pistoletën nuk ngre dot e jo më të japë çdo ditë dhjetë vagonë qymyr mbi planin.»

— Pse u shastise, — më tha, kur e pa që unë u hutova. — Hë, djalosh, luaj duart, se sot do të bëjmë tri herë mina, ndaj...

— Si, tri herë mina?! — pyeta i habitur, pasi ne gjithmonë dy herë kishim bërë.

— Po ja, mbas të dytave do të bëjmë të tretat, — foli me aq thjeshtësi, sa më çuditi dhe sikur unë të mos kuptoja që treshi vjen pas dyshit! I ktheva vagonët e mbushur, i bëra në nivel dhe kështu vazhdova deri te njëzeta. «Ç'do të thotë kjo?» — pyesja veten. Ky qenka Jakja?! Asgjë të veçantë! Bile, m'u mbush mendja top se ai qe minatori «më i vogël» i sektorit tonë, kjo me siguri vinte dhe ngaqë unë e kisha përfytyruar diçka si legjendar. Minuta sjell orën. Plasën minat e dyta dhe më pas të tretat. Numërova 45 vagonë të mbushur. Dhjetë minuta para mbarimit të turnit, u ulëm bashkë: unë, fugisti, ndimësminatori, dy shtytësit dhe më në fund Jakja.

— E, o babush, sa u bënë? — më pyeti duke qeshur.

— 45 vagonë.

— 45 me katër gisht bosh?

Unë nuk fola. Ai i pa vagonët një nga një. Me sa dukeshin bathët, ishte i kënaqur.

— Toke këtu! Toke atë dorën tëndë njomëzake, — më tha, — ç'më rri kështu, si karabina?! — dhe ma shtrëngoi dorën si për të matur qëndresën time.

Erdhi trolea. Lidhëm vagonët dhe u nisëm jashtë.

Ditët shkonin dhe unë çdo ditë e më tepër njihja Jake «enigmën», dhe përherë e më shumë bindesha se ai ishte si një trole për të gjithë ne shokët e llavës.

Njëzet e nëntë pranvera kanë kaluar, që kur Jakja filloi punën në minierë. Këtë e mora vesh në ditën e njëzetë të punës sime, kur i gjithë turni ynë kishte mbledhje për të shqyrtuar kërkesën e një punëtori të ri për largim nga ndërmarrja. Unë u futa në sallë kur mbledhja kishte filluar, pasi u vonova në llambisteri. Valë-valë diskutimet vazhdonin lidhur me shkaqet e kërkesës së Astritit për largim.

Përderisa është e drejta ime, unë dua të largohem, — thoshte ai. — Këtë e garanton edhe ligji.

— Me leje? — u dëgjua zëri i Jake Linës dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë u gjend në këmbë.

— Shoku Astrit është punëtor i ri dhe më duket se po ngutet. Mendja ma thotë e zemra ma do që ai të mos largohet nga gjiri i tyre. S'ka kënaqësi më të madhe, shokë, se kur sheh vagonët plot e përplot të mbushur me mineral nga duart tua e të shokëve të tu. Mua m'u mbushën plot njëzet e nëntë vjet në këtë punë. Kur më propozuan një punë tjetër lart, në sipërfaqe, meqë erdhën të rinjtë, unë s'pranova. S'më rrihej pa galeritë, pa pistoletë. Që kjo punë ka vështirësi, kjo dihet, po vetëm burracaku tërhiqet nga vështirësitë. Po Astriti s'më duket i tillë.

Astriti u terezit ca atje në karrige e i buzëqeshi dhe na u duk se ligjërata e Jake Linës hyri në vathën e dëshiruar.

Që nga kjo ditë, shumë muaj kanë ndërruar njëri-tjetrin. Unë hyra në vitin e dytë në minierë, e



Astriti, vagonisti i llavës sonë, nuk e zuri më në gojë atë punën e largimit. Ndonjëherë, kur shokët e ngasin e ia kujtojnë largimin, Astriti bëhet paparune e shikon nga Jakja, që rri me një nur serioz.

Dhe ne na mbulon gazi si dritë e paanë, sa herë që Hajri brigadieri, kur kalojmë nga tabelat e emulacionit (ku qëndrojnë në krye fotot e Jakes e të Astritit), i thotë «çiftit» të llavës sonë:

— Mirë në llavë, more Jake, por as këtu, në tabelë, nuk ndaheni nga njëri-tjetri?!

Mirëpo Jakja, që romuzin e ka të tijin, si plaka furkën, ia kthen me një qetësi pleqërishte:

— Epo, nuk ndahet kollaj balli i llavës, more Hajri, jo, — dhe shikon nga ne me atë fytyrë, ku lodron gazi e burrëria.

Unë kujtoj ditët e para në minierë dhe them me vete i kënaqur : «Ja, cili është Jake Lina».

REKORDE TË STANIT REVIZIONIST

(fejton)

Rekordeve të zeza të stanit revizionist u shtohet edhe ai në fushën e alkoolizmit. Për t'i shpënë më tej rezultatet e arritura e për ta vënë mbi baza më «shkencore» përdorimin e alkoolit, Bashkimi Sovjetik, Polonia, Hungaria e ndonjë tjetër shtet, organizuan kohët e fundit një «simpozium» të nivelit ndërkombëtar.

Me qëllim që t'u pritej rruga interpretimeve të gabuara, si dhe në shenjë «lulëzimi» të sovranitetit, vend organizator i simpoziumit nuk u caktua Bashkimi Sovjetik, po një nga shtetet sivëllezër të stanit revizionist. Megjithatë referatin kryesor «Zhvillimi i alkoolizmit një aspekt tjetër i rritjes së mirëqenies», ashtu siç pritej, e mbajti tërë pompozitet përfaqësuesi i Moskës:

«...Të dashur miq dhe të ftuar të zemrës! — nisi ai ligjëratën. — Bashkimi Sovjetik - mëmë është i lumtur t'u japë bijve të tij përvojën modeste në fushën eterike, çudibërëse të alkoolizmit. Ndoshta i kalojmë

caqet e modestisë, po, për hir të së vërtetës, duhet thënë se jemi të parët në botë në përdorimin e alkoolit, me një mesatare vjetore për person 64 litra. Këtë konstatim e bëjmë jo pa mburrje. Shifra e përmendur tregon mirëqënien e masave tona punonjëse, sepse duhet të kesh, — këtu folësi fërkoi dy gishtat e mëdhenj të dorës, për të qartësuar mendimin, — që të pish... Krahas kësaj ne krenohemi me faktin kuptimplotë se në armatën e alkoolistëve një numër gjithnjë e më të madh po zë rinia. Kemi përdorur të gjitha format që të nxitim rininë, madje që në bankat e shkollës jemi përpjekur të përdorim në masë alkoolin. E gjithë kjo është shprehje e atij kujdesi të madh për të degjeneruar, më falni, për ta lumturuar rininë. Gjykojeni edhe vetë. A nuk është më mirë t'i japim rinisë ca alkool, ca drogë, ta çojmë edhe në kishë, që ta largojmë atë nga ato demonstrata aq të lodhshme e me aq telashe për ne dhe policët tanë? Pastaj, edhe fitime nxjerr shteti ynë nga vodka. Ajo qoftë e bekuar, se prej saj shteti ynë i madh nxjerr 1/10-ën e të ardhurave!

Ndodh që punëtorët na vijnë edhe të pirë të hënave në punë, e s'janë në gjendje për ta filluar mbarë ditën e punës. Megjithatë kjo s'na dëmton edhe aq, fitimi që kemi është më i madh. Ku ta gjejmë t'i kemi punëtorët e të rinjtë përherë të dehur. Bekuar qoftë, pra, vodka!» — i dha fund ligjëratës, e cila u shoqërua me duartrokitje të gjata e të stuhishme.

Me interes u prit edhe kumtesa e përfaqësuesit të Polonisë: «Alkoolizmi si mjet për sigurimin e lumturisë së masave punonjëse.»

— «...Neve alkoolistëve të ndershëm polakë na bëhet zemra mal kur dëgjojmë për rrugën dhe përma-

sat që ka marrë konsumimi i pijeve çudibërëse në Kryeshtetin e kampit tonë. Argumentet dhe faktet interesante që paraqiti miku ynë, janë kuptimplote dhe një përvojë e pasur për ne të tjerët. Unë do të thosha se në Poloninë tonë lulëzojnë 800 mijë alkoolistë, të njohur zyrtarisht si të tillë... Nuk do të doja të shprehesha më mirë se parafolësi, po gëzimi që karakterizon alkoolistët ka përmasa epidemike: po t'u referohemi shifrave, del se 70 për qind e përdhunimeve, 85 për qind e divorceve, 95 për qind e akteve të vagabondazhit në Poloni kryhen nga të dehurit. Këto janë shifra sinjifikative, që kanë të bëjnë, në analizë të fundit, me liritë e pakufizuara që gëzon individi në shoqërinë tonë. 25 për qind e aksidenteve automobilistike te ne lidhen me alkoolizmin, 18 për qind të të ardhurave polakët i harxhojnë për duhan dhe për vodkë. Pra, siç del nga shifrat e përmendura nga ne, vodka ruse mbetet e pazëvendësueshme, ndërsa kontributi i Bashkimit Sovjetik në përhapjen e alkoolit mbetet një model frymëzimi».

Pas kumtesës së përfaqësuesit polak, i erdhi radha atij të Hungarisë, i cili vlerësoi lart referatin e mbajtur nga përfaqësuesi sovjetik, dhe përmendi me modesti të tepruar se në Hungari ka 400.000 alkoolistë.

Në fund, mes duartrokitjesh, e mori fjalën përfaqësuesi i vendit organizator, i cili vlerësoi nivelin e lartë të kumtesave, kërkoi që «të zbatohet sa më gjerë përvoja e shokëve sovjetikë «në konsumimin dhe përhapjen e alkoolit si një hap i rëndësishëm në synimin e përbashkët revizionist për të... lumturuar me çdo kusht popullin, sidomos rininë».

LETËR E BORGJEZISË SË MADHE KINEZE DËRGUAR HUA KUO FENIT

(pamflet)

I SHUMËNDERUARI ZOTI FENI I!

Me gëzim të papërshkruar, ne borgjezët, çifligarët dhe kundërrevolucionarët kinezë u vumë në dijeni të vendimit të KQ të PK të Kinës mbi rikthimin e pasurive, valutës dhe depozitave bankare, duke përfshirë dhe interesin, mbi rikthimin e shtëpive tona të ngritura me djersë.

Ky vendim është një dokument historik i Partisë suaj të madhe dhe një kontribut tjetër i çmuar për konsolidimin e marrëdhënive socialiste në Kinën tonë imperialiste. Ky vendim na ka gëzuar e prekur aq shumë, sa jemi gati të gjithë të hyjmë në radhët e PK Kineze, pasi po e shohim me vepra se ajo është një Parti që mbron interesat edhe të shtresave tona. I qëndron besnike parimit të lulëzimit të «100 luleve»! Kthimi i pasurisë dhe vizita e Ten Hsjao Pinit në Amerikë janë dy nga dhuratat më të çmuara, me të cilat Lartmadhëria Juaj mendoi të hapë fillimin e këtij viti kaq të mbarë për ne borgjezinë vendase.

Sigurisht që kjo dhuratë për ne nuk qe e papritur: në fund të fundit ne morëm ato që na takonin — dëshmi kjo, që vërteton më së miri drejtësinë e vijës politike të Partisë Komuniste, të formuar nga marksisti i madh Mao Ce Duni, i cili vazhdimisht ka ushqyer një respekt të madh për ne, borgjezinë e madhe.

Me ndershmërinë e një kapitalisti kinez, ne ju sigurojmë se gjithë pasurinë e kthyer do ta vëmë në shërbim të Kinës së madhe dhe të politikës së saj universale, duke lehtësuar kështu borxhet e mëdha që po merrni në botë. Për të vënë sa më mirë në jetë mësimet dhe vendimet e KQ të PKK, ne jemi duke u thelluar në konspektimin rigoroz të veprave të Mao Ce Dunit e sidomos të teorisë së tij të shquar të «tri botëve».

Thellimi i mëtejshëm i maocedunidesë, nga ana juaj, është për ne një ndihmë e madhe për investimet e kësaj pasurie në interes të Kinës së Madhe. Natyrisht, ne nuk i shohim me xhelozi lidhjet tuaja me borgjezinë e vendeve të tjera, pasi, siç na mëson Teni, ata janë vëllezërit tanë dhe, në fund të fundit, kjo është një tjetër dëshmi e zbatimit me konsekuencë të parimit internacionalist të bashkëpunimit me borgjezinë botërore. Veçse për këtë pikë kemi një vërejtje: A nuk kishte mundësi, për ta blerë qysh në Kinë kostumin kauboj Ten Hsjao Pini, pasi nuk na erdhi hiç mirë që udhëheqësi ynë e mori atë në një shtet tjetër, vërtet mik, por të huaj. Jo për ndonjë arsye të rëndësishme, po për shkak se mos mendojnë që ne nuk e kemi të zhvilluar industrinë tekstile, e për më tepër «ARIU POLAR» mund të na akuzojë për kopracë!

I DASHUR SHKËLQESI FENI I!

Vendimi i KQ të Partisë Suaj është një dokument historik jo vetëm për ne borgjezinë vendase, po për gjithë borgjezinë ndërkombëtare, e cila ju çmon e respekton si mbrojtësin besnik të interesave të saj. Rivendosja e të gjitha të drejtave dhe rikthimi i të gjitha pasurive tona, si dhe rehabilitimi i çifligarëve tanë, në prag të vizitës së hirësisë së tij, zotit Ten, në SHBA, të jeni i sigurt, madhëri, se do të kuptohet drejt nga ne.

Ato, si një fakt i pakontestueshëm, janë garanci për kapitalin Amerikan, i cili, nëpërmjet investimeve të tij, kredive, teknologjisë moderne dhe armëve, do të na ndihmojnë për ndërtimin e socializmit në Kinë, «për katër modernizimet». Dhe pikërisht këto garanci i dha plenumi i fundit me vendimin e tij të ndritur. Për të tilla vepra, të jeni i sigurt. Shkëlqesi, sè edhe Brezhnjevi ju ka zili, mbasi me siguri një veprim të tillë nuk e ka parë as në statutin që i ka lënë Hrushovi.

I NDERUARI ZOTI FEN!

Hapat historikë që ka ndërmarrë e po ndërmerr «Kina jonë e madhe, nuk ka se si të mos shihen me admirim të pafund edhe nga miqtë tanë të përtejdetit... Na lejoni, shkëlqesi, t'ju shprehim mirënjohjen tonë deri në jetë të jetëve për marrjen e vendimit të artë mbi kthimin e arit, të depozitave tona bankare dhe pasurive tona të shtetëzuara.

Pema e simpatisë për ne, e mbjellë dhe e selitur nga vetë Mao Ce Duni (që dritë i bëftë shpirti atje ku prehet!), i nxori në dritë frytet e ëndërruara

dhe të pritura nga ne.

Rikthimi i shtëpive tona dhe i pagave të larta është jo vetëm shenjë e lulëzimit të parajsës sonë përkohësisht të humbur), por, ç'është më e rëndësishmja, ajo është shenjë e besnikërisë SUAJ, si udhëheqës i Partisë së madhe, ndaj zotit Mao Ce Dun.

Gëzimi ynë i madh, që nis nga Pekini e Shangai e shkon lart në Tibet e shtrihet me madhështi deri në Mançuri, si dhe përgjërimi e veneracioni ynë ndaj Mao Ce Dunit, na detyrojnë që ne ta shpallim strategun Mao një BUDË të vërtetë! Në përshtatje të konsideracionit dhe të nderimit të paanë që kemi për Të ne, borgjezët dhe kapitalistët e ndershëm të Kinës, këto ditët e shkurtit të vitit 1979, në kuadrin e festës tradicionale të pranverës, do të organizojmë një homazh madhështor të nisur nga sheshi Tjen Nan Men, drejt vendit ku prehet për atë jetë Mao Ce Duni (që i ndirtë shpirti!».

Su sigurojmë se gjithë pasurinë e rikthyer do ta vëmë në shërbim të planit të Kinës së Madhe, për t'u bërë, ashtu siç dëshironi ju, superfuqi. Edhe juanin e fundit do ta kursejmë, që në kopshtin tonë «të lulëzojnë në çdo stinë 100 lulet dhe 100 shkollat».

Letrën po e nisim thjesht, me gjithë këmbënguljen e disa kundërrevolucionarëve të rehabilituar për ta botuar në gazetën hyjnore «Zhenminzhibao». Arsyeja është se ne ende nuk e dimë nëse edhe ju veproni si Mao Ce Duni, i cili me plot të drejtë nuk e lexonte atë gazetë.

Mirupafshim në Plenumet e tjera të KQ!

Me respekt të madh, sa Deti i Verdhë, borgjezët, çifligarët dhe kundërrevolucionarët që përfituan nga vendimi i KQ të PKK.

PEKIN, më 28 Shkurt 1979.

PASQYRA E LËNDËS

Unë dhe misri me kubikë 3
Para dhe pas Vitit të Ri 11
Për sot e për mot 20
«Ngatërrestari» 29
Njeriu që nuk hante bukën... 33
Matematika dhe... mullarët me jonxhë 41
Ditën e enjte 46
Si përfundova në... drejtori 51
Rrëfimi i një edukatoreje 55
Vjedhësi i viteve 59
Burri im dashuron.... futbollin! 63
Një telegram 70
Jakja që s'ta mbush syrin. 73
Rekorde të stanit revizionist 80
Letër e borgjezisë së madhe kineze dërguar Hua Kuo Fenit 83